

VETERANI

GAZETË PERIODIKE

NR.8(374)

GUSHT 2019

ÇMIMI: 30 LEKË

Kryeredaktor: Halil RAMA ; Zv/Kryeredaktor: Sakip Cami

Email: veterani.obvl@yahoo.com / website: www.VETERANIOBVL.ORG

JUBILARE

POGRADECI – qyteti i luleve, i pushkës dhe i penës



Ing-Myfit GUXHOLLI

FAQE 2

75 VJETORI



PESE MUAJ LUFTIME TË PËRGJAKËSHME TË BRIGADES 18 SULMUESE

Kujtimet e veteranit Uke A. Cami, ish-komisar i kompanisë së parë të batalionit të parë të Br.18 S

FAQE 4

PROFIL



“QEVERIA E PËRKOHSHME E KIMZËS”

Dod N. Luli i dhuron qytetit të Fushë- Arrësit një memorial madhështor historik kushtuar Dr. Terenc Toçit me “Qeverinë e Kimzës” të drejtuar prej tij, 1911.

Xhemal Meçi

FAQE 10

Kryetari i Komitetit Ushtarak të NATO Air Chief Marshal Sir Stuart Peach, vizitë zyrtare në vendin tonë

Për një Shqipëri anëtare të denjë të NATO-s

Lufta politike nuk i zbeh dot vlerat e LANÇ

Halil RAMA

Klima konfliktuale që po përjeton politika dhe shoqëria shqiptare, duket sikur ka lënë disi në “harresë” ngjarjen kryesore të vitit, 75-vjetorin e çlirimit të atdheut nga okupatori nazifashist. Nëse në jubile të tjerë të kësaj ngjarje, ndër më madhoret në historinë tonë kombëtare, janë përkujtuar me madhësi datat e formimit të njësive e reparteve kryesore të Ushtrisë Antifashiste Nacionalçlirimtare Shqiptare, këtë 75-vjetor lufta politike mes palëve, fatkeqsisht duket sikur e ka zbehur disi lavdinë e LANÇ.

Pikërisht për këtë arsye, Kryetari i OBVL, gjenerali mbishekullor Rrahman Parllaku – Hero i Popullit dhe Nderi i kombit fton sërish Presidentin e Republikës, SHT Z.Illir Meta, kryeministrin Rama, Ministren e Mbrojtjes Olta Xhaça, prefektët dhe kryetarët e bashkive që sa më shpejt të krijojnë komisionet përkatëse të kësaj feste të madhe jubile, ku padyshim të jenë të përfshira OBVL dhe Komiteti kombëtar i LANÇ-it. Duke evidentuar vlerat e Luftës Antifashiste Nacional-Çlirimtare të popullit shqiptar, luftë e lavdishme kjo që e radhiti Shqipërinë përkrah forcave aleate në Luftën e Dytë Botërore, Anglisë, SHBA-së dhe ish-Bashkimin Sovjetik, gjeneral Parllaku shprehet se kurrësi nuk mund të justifikohet anashkalimi i këtij jubileu të rëndësishëm nga qutoritetet qëndrore e lokale. Ndërkohë Ai reagon me tone kritike edhe ndaj atyre që për një kohë të gjatë u përpogën të errësojnë lavdinë e LANÇ-it, duke e konsideruar atë luftë civile. Gjenerali di të tregojë, sepse ai gjen mënyrën si ta shfaqë kujtesën, ashtu siç ka qenë. Në portretin e tij ne shohim një pjesë të historisë kombëtare dhe ndiejmë emocione. Prandaj e vlerësojmë shumë gjykimin e tij nëse duhet quajtur lufta si një fagje lavdie e historisë së popullit tonë, apo një luftë civile. “Luftë civile me pushtuesin brenda nuk mund të ketë... Në luftuam kundër pushtuesve nazifashistë, duke u bërë pjesë e bllokut antifashist të popujve të botës dhe fituam mbi bishën nazifashiste”, shprehet gjenerali shekullor.



Kryetari i Komitetit ushtarak të NATO Air Chief Marshal Sir Stuart vlerëson kontributin e Shqipërisë në operacionet dhe misionet e Aleancës, si dhe rolin e Shqipërisë si një faktor stabiliteti në rajon

FAQE 3

PROFILI

Promovohen dokumenatri dhe libri “Ruzhdi Baxhaku, një shok, një fisnik, një misionar”

**Bashkia e Tiranës:
“Mirënjohja e Qytetit”
për ish-kolonelin Rruzhdi Baxhaku**

Sakip Cami

FAQE 12



HISTORIA

75 vjet më parë – Kongresi historik i BRASH-it

Nga Sotir BUDINA

FAQE 5

PROFIL

GJENERAL NEXHIP VINÇANI, KOMANDANT DHE INTELEKTUAL I TALENTUAR

FAQE 6

STUDIMI

74 VITE MË PARË U KËRKUA NGA KOSOVA QË TË BASHKOHET ME SHQIPËRINË, POR U ANEKSUA NGA SERBIA

Nga Bashkim Hisari

FAQE 11

PROFIL

SHOQËRIA KA NEVOJË GJITHMONË PËR BURRA FISNIKË E SHËRBËTORË TË DËVOTSHËM

Ismet Balaj

FAQE 8

NDERIMI

Kur do të kemi një histori kombëtare të njësuar?

Kadri Tarelli

FAQE 8

JUBILARE

Me rastin e 75-vjetorit të çlirimit nga okupatori nazifashist

POGRADECI – qyteti i luleve, i pushkës dhe i penës

Ing.Myfit GUXHOLLI*

Pogradeci, qyteti i luleve, i pushkës dhe i penës është i njohur për historinë e tij të lvdishme që në lashtësi. Zbulimet arkeologjike me vendbanime palafite në fshatin Lin, Buqezë, Mëmëlisht, Starovë dhe Tushemisht, tregojnë se krahina e Pogradecit ka qenë e banuar rreth 2000 vjet p. k., që në periudhën e Bronzit.

Gjatë krijimit të shteteve të fuqishme Ilire në fundin e shek. VI p.e.s. dhe në fillim të shek. V p.e.s., Krahina e Pogradecit ka qenë e banuar nga fiset Ilire të Enkelenjve (me qendër qytetin e Enkelanës) dhe Dasaretëve (me qendër qytetin e Pelionit) të vendosur në pjesën jugperëndimore të liqenit të Ohrit (në atë kohë quhej liqeni i Lihnidës – liqeni i Dritës). Po ashtu është i ditur fakti që nga kjo zonë kalon Rruga e famshme “Egnatia”, e cila lidhte Romën me Konstandinopojën. Të gjitha këto, si dhe vetë pozita gjeografike dhe resurset e pasura natyrore e rendisin Pogradecin si një ndër zonat më të preferuara turistike të rajonit të Ballkanit e më gjerë.

Por madhështia e kësaj zone nuk qëndron vetëm këtu, por për faktin se që në kohët e lashta e deri në Luftën e Dytë Botërore, ka dhënë një kontribut të shquar për formimin e shtetit shqiptar me luftën për pavarësi kombëtare, në kulturë, në traditë dhe në tërë historinë kombëtare. Për njerëzit e shquar, për ndershmëri, besnikëri e bujari të Pogradecit kanë shkruar Bajroni dhe ambasadorë të huaj.

* * * Gjatë shek. të IX krahina e Pogradecit u pushtua nga bullgarët dhe pasardhësi i Klementit, Naumi ndërtoi afër Pogradecit manastirin me të njëjtin emër. Gjatë shekujve në vazhdim njerëzit e fshatit zbritën poshtë në rrëzë të kodrës dhe krijuan qytetin e Pogradecit, përgjatë bregut të Liqenit të Ohrit. Në vitet 1400 në shumë dokumenta përmendet që Mokrena bënte pjesë në zafetin e Aranitasve. Në kohën e sulltan Mehmetit I u vendos administrimi turk, por në zonat malore sundimtarët shqiptarë vazhduan të gëzojnë drejtat e mëparshme mbi zotërimet e tyre duke ruajtur të drejta të veçanta administrimi. Regjimi osman shkaktoi pakënaqësira në masat popullore.

KRYENGRITJET E PARA JANË UDHËHEQUR NGA GJERGJ GOLEMI, ZOT I MOKRËS, SHPATIT DHE ÇERMENIKËS.

Kjo përshkruhet edhe në këngët popullore mokrare:



• **Rrethi i Pogradecit mori pjesë masivisht në këtë luftë dhe i dha atdheut 1582 luftëtarë të armatosur në formacionet luftarake. Nga këta 144 dëshmorë, në altarin e nderit që dhanë jetën për çlirimin e atdheut dhe dy Heronj të Popullit, komandantët Reshit Çolaku dhe Kajo Karafili**

“Gjergj Golemi na çon fjalë
Angjevinin të na dalë
Me ata trima mokrarë
Kush me këmbë, kush me kalë
Kush me thika, kush me pallë...”

Kryengritjet e viteve 1432 – 1433 në afërsi të Bërzhitës i dhanë goditje dërmuese ushtrive osmane nën komandën e Ali Beut. Burimet historike tregojnë se në grykën e Mokrës janë thyer tre ekspedita osmane të organizuara nga sulltan Fatiu. Në 29 qershor 1444, u mund forca e Ali Pashës në Torvioll. Në 10 tetor 1445 arkëxhinjtë të ardhur nga Ohri u ndeshën me forcat shqiptare në fushën e Morenës. Më pas ushtritë osmane mundën të deportojnë në trevat e Pogradecit dhe në vitin 1520 – 1566 u përfshinë në Sanxhakun e Ohrit, Vilaleti i Rumelisë me qendër në Manastir. Kryengritje të vazhdueshme pati gjatë shek. XV – XVII, gjatë të cilave pushtues

si filloi fushatën e islamizimit. Popullsia shqiptare e krishterë iu nënshtrua islamizimit për t’u lehtësuar nga taksat e rënda dhe shfrytëzimi.

Gjatë shek. të XVII të e.s., në vitet 1760-1775 qyteti i Pogradecit do të pozicionohej në pjesën kodrinore të qytetit të emërtuar “Goricë” (malësi) dhe në luginën e lumit Katjel. Këto janë fillimet e para të qytetit të sotëm të Pogradecit, e cila në këtë kohë shërbente si një qendër e vogël banimi. Ndërsa qendra administrative ishte Kaza Starova (nënprefekturë), e cila gjatë shek. XVII-XIX varej nga sanxhaku i Ohrit nënsundimin e Bushatllinjve dhe më vonë kaloi nën sundimin e pashallëkut të Ali Pashë Tepelenës.

Në vitet 1860-1875 Pogradeci njihet si nënprefekturë dhe Starova kalon në varësi të tij. Përpjekjet për të qenë të lirë dhe për të ruajtur traditën, zakonet, kulturën dhe gjuhën e tyre vazhduan papushin edhe në vitet që vijuan. Si rezultat i këtyre përpjekjeve dhe vetë popullit arsimdashës pogradecar, një javë pas hapjes së shkollës së parë shqipe të hapur në Korçë, më 14 mars 1887 u hap shkolla e dytë shqipe në Pogradec.

Në fillim të shek. XX Komiteti i fshehtë për çlirimin e Shqipërisë, filloi organizimin e çetave kryengritëse. Më 1906 në krahinën e Korçës u formua çeta e Bajo Topullit, influenca e së cilës mobilizoi edhe popullin e Pogradecit, që u organizuan në çeta si ajo e Kajo Babjenit dhe Ismail Dërdushës, të cilat luftuan kundër armikut.

Në vitin 1908 në Pogradec krijohet klubi i parë shqiptar “Bashkimi” që pati si qëllim bashkimin e popullit në luftë kundër pushtuesve dhe përhapjen e gjuhës shqipe.

Shpallja e pavarësisë kombëtare e gjen

• **Kontributi i Ushtrisë Nacionalçlirimtare Shqiptare është një monument i madh i historisë sonë në Luftën e Dytë Botërore. Pa luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare, Shqipëria nuk do të ekzistonte si shtet sovran dhe i pavarur. Kjo luftë na rrjeshtoi përbri fitimtarëve, aleatëve të mëdhenj si SHBA, Bashkimi Sovjetik dhe Britania e Madhe.**

krahinën e Pogradecit nën sundimin Serb. Kjo përmendet e dhe në shkrimet e studiueses angleze Edit Durham: “Dhe në Pogradec gjetëm Serbë. Këtu e gjithë popullsia është shqipëtare. Ata pyesnin me kureshtje për fatin e qytetit të tyre dhe kishin frikë se mos pushtuesi serb u mbetej në derë përgjithnjë.” Ndonëse Pogradeci dhe fshatrat rrëzë ishin nën pushtimin Serb, Mokra dhe Gora që i takonin këtij juridiksioni ishin të lira. Në 2 dhjetor 1913, mbas shumë përpjekjesh qyteti i Pogradecit çlirohet dhe bashkohet me qeverinë e Vlorës. Në fillim të Luftës së Parë Botërore forcat Austro-Hungareze pushtojnë gjysmën e Shqipërisë deri në Pogradec, ndërsa forcat Bullgare Mokrën dhe Pogradecin.

Në 10 dhjetor të vitit 1918 forcat Franceze pushtuan Pogradecin. Me largimin e forcave Franceze më 26 maj 1920 patriotët vendas ngritën flamurin shqipëtar dhe u bashkuan me qeverinë e Tiranës. Kontributi i Pogradecit gjatë Luftës së Dytë Botërore Kontributi i popullit të Pogradecit, i krahinës së Mokrës dhe Rezës gjatë Luftës së Dytë Botërore ka qenë i madh. Në ditët e para të prillit 1939 në Pogradec u organizuan shumë demonstrata dhe populli pogradecar kërkoi të luftonte me armë, por gjithçka ishte e kotë sepse e gjithë Shqipëria ra nën pushtimin Italian.

Në 28 tetor 1940 Italia i deklaroi luftë Greqisë dhe nënprefektura e Pogradecit u bë shesh luftimesh dhe u nda përgjysëm. Dëme të shumta iu shkaktuan popullit, djegiet dhe dhuna u shtuan deri në 14 prill 1941, kur forcat greke u tërhoqën duke kapituluar. Në 1941 Rreshit Çollaku organizon qëndresën e popullsisë kundër pushtuesve duke u bërë komandant i çetës partizane të krijuar në këtë rreth më 17 Prill 1942. Më 22 Maj 1942 u formua Batalioni i Mokrës me 300 luftëtarë. Janë të njohura gjithashtu aksionet luftarake të njësiteve të armatosura të qytetit dhe të fshatrave të Pogradecit, si Çezmës, Malit të Thatë,



(Vijon në faqen 7)

AKTUALITET

Kryetari i Komitetit Ushtarak të NATO Air Chief Marshal Sir Stuart Peach, vizitë zyrtare në vendin tonë

Për një Shqipëri anëtare të denjë të NATO-s

Kryetari i Komitetit ushtarak të NATO Air Chief Marshal Sir Stuart Peach vlerëson kontributin e Shqipërisë në operacionet dhe misionet e Aleancës, si dhe rolin e Shqipërisë si një faktor stabiliteti në rajon.

Presidenti i Republikës, Sh.T.Z. Ilir Meta vlerëson mbështetjen e dhënë nga Komiteti Ushtarak i NATO-s për projektin e Bazës Ajrore të Kuçovës, duke garantuar se bashkëpunimi me Aleancën ka një rëndësi strategjike për sigurinë kombëtare dhe rajonale. Gjatë takimit me kryetarin e Komitetit Ushtarak të NATO-s, Marshall Sir Stuart Peach, më 23 korrik 2019, në selinë e Presidencës në Tiranë, Presidenti Meta siguroi se Shqipëria do të vijojë kontributet e saj në misionet në Afganistan, Kosovë, Bosnje-Hercegovinë, Mali, Detin Egje, Letoni, Rumani, Mesdhe, etj.

Duke e vlerësuar si legjitime kërkesën e NATO-s për ndarjen e drejtë të barrës së përgjegjësisë, Kreu i Shtetit theksoi se i ka kërkuar Qeverisë



t'u përmbahet angazhimeve zyrtare të Shqipërisë, duke rritur vit pas viti buxhetin deri në 2% të GDP në vitin

2024.

"Shqipëria është një anëtare e NATO-s, e pozicionuar në mënyrë të ven-

dosur në procesin e integritetit europian, duke pritur që të hapë negociatat e pranimit të saj.

Shqiptarët e kanë bërë zgjedhjen e tyre, për t'u bashkuar me NATO-n dhe Bashkimin Europian. Askush nuk mund t'ia ndryshojë rrugëtimin këtij projekti strategjik.

Do punoj pa u lodhur për një Shqipëri të qëndrueshme, demokratike dhe anëtare të denjë të NATO-s, që siç tha Sekretari i Përgjithshëm Stoltenberg gjatë vizitës së Tij në Tiranë, ka në zemër demokracinë", – u shpreh Kreu i Shtetit.

Gjithashtu, Presidenti Meta nënvizoi se roli dhe prezenca e NATO-s në rajon është faktor kyç për sigurinë, paqen dhe stabilitetin e Ballkanit Perëndimor.

Kreu i Shtetit shprehu mbështetjen e Tij ndaj përpjekjeve të qeverisë së Kosovës për integrimin në NATO dhe ngritjen e Forcave të Armatosura, si "kontribut shtesë për sigurinë dhe stabilitetin afatgjatë të rajonit".



Gjeneral brigade Shehu priti në takim komandantin e Forcës Tokësore të FA italiane, gjenerallejtënant Salvatore Farina

Bashkëpunimi ushtarak

Shqipëri - Itali është i rëndësishëm

Në kuadër të bashkëpunimit bilateral në fushën e Mbrojtjes, midis Republikës së Shqipërisë me Republikën e Italisë për vitin 2019, me ftesë të komandantit të Forcës Tokësore të Forcave të Armatosura shqiptare gjeneral brigade Albert Mullai, në datat 15 - 16 korrik 2019, komandanti i Forcës Tokësore të Forcave të Armatosura italiane, gjenerallejtënant Salvatore Farina dhe ekipi që e shoqëron zhvilloi një vizitë pune në vendin tonë.

Gjatë qëndrimit në vendin tonë gjenerallejtënant Farina u prit në një takim të veçantë dhe nga zëvendëseshëfi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneral brigade Manushaqe Shehu.

Gjeneral brigade Shehu, pasi e uroi gjeneral Farinën dhe ekipin që e shoqëron për mirëseardhjen në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, vlerësoi bashkëpunimin shumë të mirë midis dy vendeve në fushën e Mbrojtjes dhe Sigurisë. Në mënyrë të veçantë gjeneral brigade Shehu u ndal në bashkëpunimin e frytshëm në operacione e misione ushtarake në kuadër të Aleancës, arsimimin, edukimin ushtarak si dhe në stërvitjet.

Ky bashkëpunim dhe mbështetje në fushën ushtarake, ndër vite ka qenë i shkëlqyer dhe me tendencë për konsolidim të mëtejshëm, siç është edhe bashkëpunimi ndërmjet Forcës Tokësore italiane dhe shqiptare, bashkëpunim i cili me siguri do të jetë tepër i frytshëm falë edhe kësaj vizite.

Gjithashtu gjeneral brigade Shehu i

uroi atij dhe ekipit që e shoqëron vizitë të suksesshme në Komandën e Forcës Tokësore, si dhe qëndrim të këndshëm në Shqipëri.

Nga ana e tij gjeneral Farina, pasi falënderoi gjeneral brigade Shehun për pritjen e ngrohtë dhe tepër miqësore, vlerësoi bashkëpunimin e shkëlqyer midis dy vendeve dhe shprehu gatishmërinë për të vijuar në këtë bashkëpunim dhe në të ardhmen. Duke çmuar kontributin në operacione e misione të Aleancës, sidomos në RSM (Train Advise Assist Command, TAAC - West, Herat) dhe KFOR, gjeneral Farina u shpreh se ka ardhur koha që bashkëpunimi midis dy forcave tona tokësore të strukturoret në terma kohore afat-mesme (2-3 vjeçare) duke përfshirë trajnime, kurse dhe stërvitje të kombinuara dhe të përbashkëta, gjë e cila do të rriste efikasitetin e bashkëpunimit.

Të dy bashkëbiseduesit, duke vunë në dukje se vizitat reciproke të liderëve civil dhe ushtarak të dy vendeve kanë ndikuar në forcimin e mëtejshëm të bashkëpunimit midis tyre, shprehën bindjen se bashkëpunimi ushtarak Shqipëri - Itali është i rëndësishëm, jo vetëm në kuadër të bashkëpunimit dypalësh, por edhe si dy vende anëtare të NATO-s dhe do të njohë gjithmonë rritje në interes të përbashkët.

Më herët, komandanti i Forcës Tokësore të FA italiane, gjenerallejtënant Salvatore Farina, u prit në një takim kortezie dhe nga zëvendësministri i Mbrojtjes, z. Petro Koçi.

Gjeneral Peach vlerësoi rolin e Shqipërisë si një faktor stabiliteti në rajon

Kreu i Komitetit Ushtarak të NATO-s gjeneral sir Stuart Peach zhvilloi një vizitë zyrtare në Tiranë, aty ku u zgjodh dy vjet më parë në krye të strukturës drejtuese ushtarake të Aleancës. Gjeneral Peach i Forcës Ajrore të Mbretërisë së Bashkuar, u prit me truporje nderi nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku. Më pas kreu i Komitetit Ushtarak të Aleancës u prit në takim nga ministrja e Mbrojtjes Olta Xhaçka, me të cilën diskutuan për situatën e sigurisë në rajonin tonë. Gjeneral Peach vlerësoi rolin e Shqipërisë si një faktor stabiliteti në rajon dhe kontributin e vendit tonë në misionet e NATO-s. Temë e diskutimit ishte e investimi i NATO-s në Bazën Ajrore të Kuçovës, për të cilën dy bashkëbiseduesit vlerësuan rëndësinë strategjike që ka ky investim, jo vetëm për Aleancën, por edhe për vendin tonë.



Komiteti Ushtarak i NATO-s përbëhet nga shefat e shtabeve të forcave të armatosura të vendeve anëtare të Aleancës.

Shqipëria do të vazhdojë të kontribuojë në operacionet dhe misionet e NATO-s

Pas ceremonisë së pritjes me truporje nderi, kryetari i Komitetit Ushtarak të NATO Air Chief Marshal Sir Stuart Peach zhvilloi një takim me shefin e Shtabit të Përgjithshëm të FARSH gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku.

Gjeneral brigade Kollçaku pasi e njohu Air Chief Marshal Peach me zhvillimet më të fundit të FARSH u shpreh se Shqipëria është e vendosur në angazhimin për të përmbushur shpenzimet për Mbrojtjen sipas asaj që është rënë dakord në Samitin e Wellsit duke e siguruar atë se Shqipëria do të vazhdojë të kontribuojë në operacionet dhe mis-

ionet e NATO. Nga ana e tij, kryetari i Komitetit ushtarak të NATO Air Chief Marshal Sir Stuart vlerësoi kontributin e Shqipërisë në operacionet dhe misionet e Aleancës, si dhe rolin e Shqipërisë si një faktor stabiliteti në rajon.

Gjatë takimit bashkëbiseduesit diskutuan çështje me interes të Aleancës dhe mbi situatën në rajonet ku NATO është e angazhuar në misione dhe operacione, si dhe vlerësuan si shumë të rëndësishme solidaritetin dhe unitetin mes vendeve të Aleancës për t'i bërë ballë sfidave me të cilat ajo përballet.

Kujtimet e veteranit Uke A. Cami, ish-komisar i kompanisë së parë të batalionit të parë të Br.18 S

PESË MUAJ LUFTIME TË PËRGJAKËSHME TË BR. 18-të SULMUESE

KRONOLOGJI

U formua në Sllatinë të Dibrës më 18 gusht 1944 sipas urdhërit të Shtabit të Pëgjithshëm mbi bazën e tre batalioneve, të Dibrës, Martaneshit sipas urdhërit të Shtabit të Pëgjithshëm mbi bazën e tre batalioneve, të Dibrës, Martaneshit, Cermenikës si dhe të partizanëve të ardhur nga krahina të tjera të vendit.

Në drejtimin e Brigadës në ditën e formimit ishin Esat Ndreu, komandant, vëllai i patriotit dhe luftëtarit Elez Isuf Ndreu, Zëvendës komandant Zoi Themeli, Mico Kallamata komisar dhe Sotir Vullkani zëvendës komisar. Më vonë u bënë ndryshime në komandën e Brigadës. Petrit Dume u bë komandant brigade, Hilmi Causholli, komisar, Xhevdet Petrela, Zëvendës komandant, Teme Sejko, Zëvendës komisar, Milo Qirko Zëvendës komisar. Gafur Korca ishte komandant i batalionit të parë, Qazim Peshku, komandant i batalionit të dytë, Ajat Rusi, komandant i batalionit të tretë dhe Gafur Mehmeti komandant i batalionit të katërt.

LUFTIMET KRYESORE

Me 18 gusht 1944 në Slatinë të Dibrës formohet Brigada e 18 Sulmuese me katër batalione, batalionin e Dibrës, batalionin e Martaneshit, batalionin e Çermenikës dhe batalionin e Ri që u formua ato ditë.

Gafurr Korça u bë komandant i batalionit të parë, Rexhep Doda, komisar i këtij batalioni, Ferit Muha nga Bllaca u bë komandant i kompanisë parë në këtë batalion, Uke Cami komisar i kompanisë së parë.

Fill pas formimit Brigada u angazhua në luftime çlirimtare. Me 25 gusht na u dha për detyrë çlirimi i Dibrës së Madhe.


Batalioni i parë u vendos në frontin Bajnisht-Kojnarë, batalioni i katërt u vendos në frontin Bofmollë-Ura e Spiles. Frontet e tjera ishin zënë nga një pjesë e forcave të Divizionit të parë. Pas 24 orë luftimesh forcat gjermane në qytet të ndihmuara edhe nga batalioni "Drini" i komanduar nga Dilaver Dine, u tërhoqën nga Dibra e Madhe. Dibra u çlirua.

Brigada e katërt shqiptaro-maqedonase e drejtuar nga Qemal e Nexhat Agolli dhe ku bëntë pjesë edhe kushëriri im Esat Cami, mori drejtimin e Strugës dhe më pas të Shkupit.

Brigada e 18 mori urdhërin për të shkuar në drejtim të Kukësit e të Prizrenit, në mbështetje të Brigadës 5 Sulmuese ku Hajdar Dushi kishte hasur rezistencë nga forcat e Muharrem Bajraktarit në Kallanë e Dodës.

Batalioni i parë i komanduar nga Gafurr Korça dhe Rexhep Doda nga mesi i natës filloi marshimin në drejtim të Kalasë së Dodës dhe në orën pesë të mëngjesit sulmon Kalanë, nga Kalla, Vlesha e Sll-ova dhe nga Zall-Kalisi dhe pas pesë orë luftimesh të përgjakshme u muar Kalaja. Një pjesë e mirë e luftëtarëve nacionalistë u kthyen me ne dhe luftuan deri në fund kundër gjermanëve.

Këtu kemi parë edhe masakrën më të madhe njerëzore, Hajdar Dushin me



22 shokë të vrarë, ndërmjet tyre edhe 2 shoqe partizane, të cilat i kishin xhveshur lakuriq dhe u kishin ngulur nga një hu në prapnicë dhe i kishin mbështetur për shkëmbi. Urrejta ndaj pushtuesit por edhe ndaj atyre që u shkonin pas si nacionalistë e antikomunistë nuk kishte kufi dhe nuk mund të tregohet. Përsëri njoftohemi se shtabi i brigadës së pestë është në rrezik në fshatin Ujmishtë nga forcat Muharrem Bajraktarit.

Pas rrethimit që i bëme forcave të Bajraktarit e çliruam shtabin e Brigadës së pestë, por nga kjo brigadë kishin mbetur në luftim 60 partizanë, kryesisht të vrarë nga forcat e Muharrem Bajraktarit. Ja ku kishte arritur vëllavrasja midis shqiptarëve, antifashistëve dhe antikomunistëve.

Populli i kësaj zone më shumë mbështeti Nacional- Çlirimtarin se sa Muharrem Bajraktarin dhe u rreshtua në Brigadën e 24 kundër gjermanëve.

Në këtë momente tabllo e luftimeve ishte e tillë:

Shtabi i Br.18 ishte vendosur në Bicaj, shtabi i Br. 5 në Has, ndërsa forcat gjermane dhe mbështetësit e tyre në Kukës e Prizren.

Batalioni parë i Br 18 së bashku me batalionin e Lumës banë një aksion tek kulla e Lumës dhe asgjësuan një repart gjerman që vinte nga Prizreni, ku u kap rob edhe qarkkomandanti i Kukësit.

Sulmonit Parë të Br 18 ju dha detyrë të baltonte Topojanin, Zapodin dhe Dragashin. Në Dragash na u dha urdhëri për të marshuar drejt Kukësit, ku në fshatin Bardhoc bllokuam rrugën automobilistike.

Kishim këputur në mes edhe urën dhe qëndronim në pritje për ardhjen e autokollonës gjermane. Pranë meje ishin Shaqir Shira nga Zall Dardha dhe Jonuz Duka nga Maqellara.

I pari hapi zjarr partizani Dine Rama nga Shumbati. Gjermanët pa urë kalimi ishin të detyruar të zbrisnin nga makinat dhe të zinin front në tokë por koha punonte për ne sepse ne ishim të pozicionuar dhe të gatshëm për të qëlluar. Në një darë

të hekurt pas katër orë luftimesh, gjer-
manëve u vjen përsëri ndihma në njerëz,
technikë luftarake e logjistike. Ndërsa par-
tizanëve pas katër orë luftimeve filluan
tu mbaronin rezervat, por edhe tërheqja
ishte e vështirë.

Midis Përbregut dhe Bardhocit u organizua tërheqja me luftim, por patëm të vrarë e të plagosur. U plagosën Met Harullai, Azis Asllani etj.

Të nesërmen batalioni parë organizoi një aksion tjetër në fund të fshatit Morinë ku asgjësohet plotësisht një kompani gjermane por u vra edhe partizani Eles Mena nga Bllaca. Pas tërheqjes nga Dragashi, batalioni i katërt ishte urdhëruar për të sulmuar kalanë e Prizrenit, ndërsa batalioni i parë do të sulmonte Zhurin. Brigada e pestë do të sulmonte Prizrenin.

Pas gjashtë orë luftimesh Prizreni u çlirua. Pastaj të gjitha forcat partizane përqëndrohen për çlirimin e Kukësit. Forcat gjermane largohen dhe përqëndrohen në Shkodër. Ndërsa forcat e Brigadës sonë ndodhen në Luginën e Valbonës në Tropojë, njoftohemi me 29 nëntor se forcat partizane kanë çliruar Shkodrën.

Luftën e vazhduam kundër forcave që komandoheshin nga Halil Alia, Muharrem Bajraktari, Gjon Marka Gjoni. Në përpjekje me forcat e Halil Alisë u vranë 13 partizanë të batalionit të Tropojës.

Më 1 janar 1945 na u dha urdhëri për të kaluar në Mirditë, batalioni i parë dhe

batalioni i katërt i Brigadës 18. Batalioni i parë do të kalonte qafën e Malit dhe batalioni i katërt do të kalonte Qafën e Kumbullës. Bota binte papushim dhe kishte arritur lartësinë dy metra. Duke kaluar qafën vdiqën katër partizanë. Tuneli i dëborës bllokohej në çast. Në krye të kolonës ishin Gafurr Korça, Rexhep Doda, Albert Papparisto, Ferit Muha. Alberti ishte nga Elbasani dhe nuk ishte mësuar me dimra të tillë.

Asnjë shtëpi nuk duket në horizont. Jemi të lodhur e të djersitur. Po na humb edhe shpresa e ndonjë strehimi të afërt. Gjashtëqind partizanë rrezikohen të vdesin në dëborë nga të ftohtit , nga lodhja dhe nga uria. Ky acar ishte

- *Luftimet e kryera së bashku me Brigadën e V Sulmuese në malin e Korabit kundër forcave gjermane që bënë të dështonte faza e fundit e operacionit gjahu i dhelprave;*
- *Kryerja e disa aksioneve luftarake kundër autokolonave gjermane gjatë tërheqjes në rrugën automobilistike Prizren/ Kukës/ Pukë dhe lufta për clirimin e Kukësit;*
- *Luftimet përtej kufirit shtetëror për clirimin e qytetit të Dibrës së Madhe , për clirimin e Kërçovës dhe të Prizrenit.*

edhe më i keq se beteja. Kishim kaluar qindra beteja dhe nuk ishin sprapsur ndersa ky acar e kjo dëborë ishin të tmershme. Ato po na merrnin jetën ngadalë ngadalë. Papritmas hasi në murin e një avllie. U futëm brenda në kasollen e braktisur dhe ndezëm me shpejtësi një zjarr të madh për të shpëtuar nga ngrirja. Disa metra më larg pamë edhe një shtëpi. Ju drejtuam , pjesa e mbetur , se një kasolle nuk mori vetëm dyqind burra. Ishte ora dy e natës dhe thirrja jonë në këtë natë të acartë nuk dëgjohej. Por pas disa thirrjeve e krismave të njëpasnjëshme u dëgjua një zë burri : Kush jeni ? Jemi partizanë, ju përgjigjëm. Hajdeni Bujrum sa të jeni, u përgjigji i zoti i shtëpisë. Jemi shumë or mik. Do tju shpërndajmë në të gjithë fshatin me djemtë e mij, tha burri me bujari.

Në shtëpinë e tij u strehua Ferit Lleshi, Hamdi Doda, Pali Carapuli, Sali Hoxha etj. Kështu u shpërndanë dhe kaluan natën të gjithë partizanët. Nuk bahej fjalë për të ngrenë, pasi as fshatarët nuk kishin ç'të hanin për vehte, por vetëm për të futur kokën e për të shpëtuar nga ngrirja e nga vdekja. Pasi dëbora ngriu kalonim mbi dëborë dhe udhëtuan drejt Mallkuqes, Domgjorit, Iballës e Pukës.

Në organizimin e ri të pasluftës Brigada e 18 u caktua të shkonte e të shërbente në Gjirokastrë.

*Veterani Uke A. Cami ka qenë komisar i kompanisë së parë të batalionit të parë të Br.18 S dhe kujtimet e tij i ka përmbledhur në librin me titull “Shpirti ynë liridashës”

HISTORIA

75 vjet më parë – Kongresi historik i BRASH-it

Nga Sotir BUDINA*

Shtatëdhjetë pesë vjet më parë, më 8 gusht të vitit 1944, zhvilloi punimet Kongresi i Parë historik i Rinisë Antifashiste Shqiptare. Kongresi u mbledh për të analizuar punën e luftës e rinisë në të gjitha krahinat e vendit dhe për të përcaktuar detyrat e saj në mësymjen përfundimtare kundër pushtuesve e tradhëtarëve dhe për rindërtimin e Shqipërisë së re.

Do të kalojnë shumë vite dhe kjo datë do të kujtohet gjithmonë si një ngjarje e shënuar në historinë e Shqipërisë, pasi për herë të parë rinia shqiptare në këtë kongres, si asnjëherë tjetër u bashkua dhe u hodh totalisht në luftë kundër okupatorit nazifashist dhe tregoi aftësitë dhe forcën e saj. Ajo nga zjarri i saj rinor i dha zjarr Luftës Nacionalçlirimtare an e kand Shqipërisë, duke mbushur me të rinj njësitet guerrile të qyteteve dhe fshatrave, batalionet, brigadat e divizionet partizane që luftuan me heroizëm e vetmohim deri në çlirimin e plotë të atdheut.

Pikërisht për këtë arsye, pushtuesit në të gjitha krahinat e vendit u munduan ta pengonin atë duke internuar, burgosur, torturuar e pushkatuar me dhjetra të rinj antifashistë. Shumë prej tyre u varën dhe në litar, por ata nuk u përkulën. Me qindra janë heronjtë dhe dëshmorët që rinia jonë heroike i dha kësaj lufte të drejtë në të gjitha krahinat e vendit. Të paharruar do të ngelen heronjtë e parë të rinisë antifashiste shqiptare, si Midhi Kostani e Kiço Greço në qytetin e Korçës që u varën në litar, Qemal Stafa e Misto Mame në Tiranë, Heronjtë e Vigut në Shkodër, Persefoni Kokëdhima në Gjirokastrë, Margarita e Kristaq Tutulani në Berat, etj; heronj këta që u bënë shembull heroizmi dhe bashkimi në luftë kundër okupatorit nazifashist. Populli shqiptar përulet me respekt përpara gjakut dhe saktificave të këtyre heronjve.

Në verën e vitit 1944, kur lufta kundër pushtuesit kishte marrë përmasa të mëdha në të gjithë vendin dhe kur trupat sovjetike po i afroreshin Ballkanit Perëndimor, Organizata e Rinisë Antifashiste Shqiptare, e drejtuar me guxim e mençuri nga Sekretari i saj i Parë, Nako Spiru, thirri Kongresin e saj të parë në Helmës të Skraparit. Në këtë vend malor që edhe në të kaluarën ka qenë vatër e çetave të Rilindjes sonë Kombëtare, më 8 gusht 1944, në frymën e një entuziazmi të përpshkruar u hap Kongresi i I-rë i Rinisë Antifashiste Shqiptare.

Në këtë kongres morën pjesë 285 delegatë (nga të cilët 75 ishin të reja) që përfaqësonin rininë dhe pionierët e të gjitha krahinave dhe qyteteve të Shqipërisë dhe të Ushtrisë Nacionalçlirimtare. Me një dashuri dhe entuziazëm të paparë u pritën delegatët e Divizionit të I-rë S, të Brigadave të I-rë, IV-t dhe të V-të Sulmuese, gjithsesj 27 veta që vinin nga vija e parë e luftës për çlirimin e Shqipërisë së Veriut, duke marshuar më këmbë me qindra kilometra nga Mirdita dhe Dibra deri në Helmës të Skraparit, për të marrë pjesë në këtë kongres historik të Rinisë Antifashiste Shqiptare ku do të bëhej bilnaci i luftimeve dhe do të caktoheshin detyrat deri në çlirimin e plotë të atdheut.

Zëri i delegatëve të Divizionit të I-rë, të zgjedhur nga partizanët më të mirë, të dalluar në luftën kundër pushtuesve, në takimet dhe bisedat e zjarrta që bëheshin gjatë ditëve të zhvillimit të Kongresit, dëg-



johej me vëmendje të veçantë. Me diskutimet e tyre, Fatmir Gjata, Dhori Panariti, Katina Starjo etj dhanë një kontribut të vyer për përcaktimin e detyrave imediate që i dilnin Rinisë Antifashiste Shqiptare, për edukimin e saj dhe për çlirimin e rindërtimin e vendit të shkatërruar nga lufta.

Për 10 ditë rresht Kongresi i BRASH-it diskutoj dhe analizoj punën që ishte bërë për bashkimin e Rinisë Antifashiste Shqiptare dhe sukseset e arritura prej

saj në luftën kundër okupatorit nazifashist, si dhe u përcaktuan detyra të rëndësishme për një pjesëmarrje më të madhe të rinisë në repartet partizane dhe për aktivizimin e mëtejshëm në luftën Nacionalçlirimtare. Pikërisht për këtë, fitorja e 28 Nëntorit 1944 që shënoi çlirimin e plotë të Shqipërisë ishte dhe fitore e madhe e Rinisë Antifashiste Shqiptare që përbënte 70 përqind të efektivit të forcave partizane dhe që i dha atdheut me qindra dëshmorë në të gjitha krahinat e vendit.

Kongresi i Parë i BRASH-it, për detyrat shumë të rëndësishme që përcaktoi, për një pjesëmarrje më të madhe të rinisë në luftën Nacionalçlirimtare për çlirimin e plotë të vendit, për miqësinë dhe dashurinë e singertë që ngjalli ndërmjet delegatëve, për punën edukative që u bë me delegatët gjatë ditëve të Kongresit, si dhe për detyrat shumë të rëndësishme që përcaktoi për rindërtimin e vendit të shkatërruar nga lufta, etj, ka mbetur dhe do të mbetet i paharruar në kujtesën e gjithë delegatëve, të cilët edhe pse kanë kaluar 75 vjet nga ajo kohë, i kujtojnë me mall ato ditë ta lavdishme.

Duke kujtuar ato ditë të lavdishme të Luftës Nacionalçlirimtare, kur ideali i madh i lirisë na çoi në vijën e parë të frontit në ndeshjen drejtpërdrejt me pushtuesin e egër, pa iu trembur plumbave që merrnim në kraharor, duke dhënë dhe jetën për një atdhe të lirë e demokratik, i bëjmë thirrje rinisë së sotme që të luftojë më shumë për një jetë më të mirë dhe për Shqipërinë Europiane.

Megjithë kontributin e madh që dha rinia shqiptare në luftën kundër okupatorit, idealet e saj për një Shqipëri të lirë dhe demokratike, për një jetë më të lumtur, megjithëse kanë kaluar 75 vjet nga përfundimi me fitore i asaj lufte legjendare, asnjëherë nuk u realizuan. Idealet e saj u tradhtuan nga drejtuesit e sistemit diktatorial, por edhe sot rinia endet nëpër botë për të gjetur një vend pune.

Në këtë përvjetor të 75-të të Kongresit të I-rë të BRASH-it, kur Shqipëria është tashmë anëtare e NATO-s dhe pret çeljen e negociatave me Bashkimin Europian, shprehim bindjen se rinia dhe populli shqiptar do të realizojnë aspiratën e tyre të integritetit të plotë euroatlantik.

***Delegat i Divizionit të I-rë në Kongresin e I-rë të BRASH-it**

INAGUROHET LAPIDARI NË FSHATIN MBREZHAN, BASHKIA KËLCYRË

Me nismën e bashkëfshatarëve Peço Sevo, Kolo Nasi e Aleko Qyra në vendin e quajtur Marmuricë, pranë urës mbi lumin Vjosa u ngrit një lapidar memorial përkujtimor kushtuar bijëve të fshatit Mbrezhan të cilët u vranë, plagosën e internuan në Operacionin e Qershorit 1944 nga nazistët gjermanë. Kjo dëshirë e pjesëtarëve të familjeve dhe të afërmeve u bë realitet në vitin e 75 – vjetorit të ngjarjes së hidhur duke vënë në vend amanetin e tyre (02 Qershor 1944 – 02. Qershor 2019). Në këtë ceremoni emocionuese, homazh përkujtimor e konceptuar si festë për gjithë fshatin, morën pjesë shumë bashkëfshatar ardhur dhe nga qytetet ku jetojnë, pjestar të familjeve, të afërm dhe të ftuar të tjerë. Nderuan me pjesëmarrjen e tyre, kryetari bashkisë z. Klement Ndoni, kryeplaku i fshatit Mbrezhan Leonard Qirici, anëtar kryesisë i OKFD, dega Përmet z. Muharem Kamani etj.

Pjesëmarrësit u grumbulluan rreth lapidarit, lexonin emrat e epitafin shkruar me gërma të arta: Leonidha Ndina, Mina Gjika, Rako Toslluku, Manol Sevo, Koço Kongoli, Dhame Çajupi, Gjike Toslluku dhe Cace Elmazi, ledhatorin pllakën e mermerit duke provuar rreshqitje lotësh sikur i takonin dhe çmалleshin me ta. Ata u përjetësuan në këtë lapi-



dar madhështor. Shiritin e inaugurimit e preu kryetari bashkisë Klement Ndoni dhe shqiptaro – amerikanë Aleko Qyra. U vendosën tufa me lule nga kryetari bashkisë, në emër të organizatës së familjeve të dëshmorëve nga anëtarët e saj Kolo Nasi e Sofo Xhavora dhe të bashkëfshatarëve Peço Sevo, i cili duke përshëndetur uroj bashkëfshatarët e pranishëm e veçanërisht ata që kanë ardhur nga larg. Realizuan një endër duke ngritur këtë lapidar në kujtim të bashkëfshatarëve në 75 – vjetorin e ngjarjes. Ky lapidar është projektuar kaq bukur nga Ing. Simon Simo Kondo, i cili u realizua nga Sofo Xhavora, Aleko Qyra, Apostol Graçi, Themo Qyra duke falënderuar sponsorët.

Duke sjellë ndërmend kujtimet nga babai Rako Toslluku i cili i mbijetoi ngjarjes, vajza Kristulla Toslluku (Konomi), aty për aty ja mori këngës me të cilën ju bashkua dhe grupi i fshatit. Zoti Aleko Qyra shtroi një drekë përkujtimore për të pranishmit në ambientet e shkollës “Petro Nasi”

**Përgatiti kronikën
Kol. Pension Muharem KAMANI**

PROFIL

Në 103 vjetorin e lindjes të gjeneralit që u burgos dhe internua nga diktatura

GJENERAL NEXHIP VINÇANI, KOMANDANT DHE INTELEKTUAL I TALENTUAR

Nga Myfit GUXHOLLI*

Nexhip Vinçani lindi në Vinçan të Korçës më 10 gusht 1916. Biri i atdhetarit të shquar Kareman Vinçani, pasi mbaroi shkollën fillore në Vinçan, filloi mësimet në Liceun e Korçës. Më pas vazhdoi mësimet në Shkollën Mbretërore Ushtarake në Tiranë dhe i përfundoi në Gjimnazin e Shkodrës në vitin 1939. Ishte shok i ngushtë i Qemal Stafës e Sadik Bekteshit.

Nexhip Vinçani, studimet universitare i kreu në Romë. Sa dëgjoi kushtrimin e Nënës Shqipëri, si gjithë bashkëmoshtarët u kthye në atdhe. Menjëherë, Nexhipi dhe shoku i tij i ngushtë, Pëllumb Dëshnica caktohen nga Qarkori i Korçës të organizojnë rezistencën dhe luftën kundër okupatorit Italian.

Familjen e Nexhipit e kishte përshkuar era e barutit në luftën për lirinë e atdheut që në kohën e luftës të rilindasve tanë të shquar për liri e pavarësi kombëtare. I jati i tij, Kareman Vinçani luftoi kundër rebelëve të Haxhi Qamilit. Ishte bashkëpunëtor aktiv i Themistokli Gërmenjit, pjesëmarrës në Kongresin e Lushnjës si përfaqësues i parë i n/prefekturës Korçë.

Karemani, mik i Fan Nolit, Themistokli Gërmenjit, Bajo Topullit e Mihal Gramenos do të ishte dhe një antifashist i madh si anëtar i Këshillit të Përgjithshëm Nacionalçlirimtar. At e bir qenë pjesëmarrës aktivë në luftën për çlirimin e vendit nga thundrra e fashizmit.

ORGANIZATOR I TALENTUAR I NJËSITEVE TË LANÇ

Më 28 Nëntor 1941, Pëllumb Dëshnica dhe Nexhip Vinçani folën në një miting kundër okupatorit. Pëllumbi u arrestua dhe u dërgua në Ventontene, Itali, ndërsa Nexhipi me ndihmën e shokëve i shpëtoi internimit.

Veprimtaria patriotike dhe atdhetare e Nexhip Vinçanit është shumë e madhe. Ai kishte aftësi, burrëri e trimëri të rrallë. Si organizator i përkryer i LANÇ e shtriu aktivitetin e tij nga fshati në fshat për të rrizguar traditat patriotike në Qarkun e Korçës. Me pasionin e një nacionalisti demokrat, që në qershor-shtator 1942 krijoi njësitet e armatosura në disa fshatra. Të tilla ishin Çetat e Gorës, Mestan Ujanikut, Gorë-Oparit, Malit të Thatë, Vithkuqit e Rrëzës, Kolonjës, Bilishtit e Mokrës me komandant Reshit Çolakun. Nexhipi, i jati dhe vëllezërit, Sami, Skënder, Ali dhe Sali dhanë një ndihmesë të madhe në organizimin e LANÇ në Qarkun e Korçës. Aliu - komandant çete në fillimet e luftës; Samiu - komandant brigade, Skënderi - kuadër i lartë në Ministrinë e Brendëshme..., Saliu në pushtetin vendor.

Për merita të veçanta në organizimin e LANÇ në Qarkun e Korçës, për aftësi organizuese dhe komanduese, Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Antifashiste Nacionalçlirimtare e emëroi komandant të Shtabit të Qarkut të Korçës.

Nexhip Vinçani, nga viti 1940 deri në maj 1943 ishte drejtues dhe organizator kryesor në Qarkun e Korçës, komandant dhe intelektual i talentuar. Në Qarkun e Korçës në fillim ai organizoi Njësitet e armatosura. Më vonë, në fillim



të vitit 1942 deri në shtator të atij viti punoi në organizimin e çetave, si ajo e Pogradecit, Gorës, Vithkuqit etj, gjithsej 15 çeta partizane.

Në janar-mars 1943 numri i çetave sa vjen e shtohet. Baza politike e këtyre çetave ishin Këshillat Nacionalçlirimtare të zgjedhura nga populli, pothuajse në çdo fshat të Qarkut të Korçës.

ORGANIZIMI I USHTRISË TË RREGULLT PARTIZANE

Në shtator 1943 filloi krijimi i Ushtrisë së rregullt partizane me krijimin e batalioneve me organika të plota. Numri i tyre arriti në 8: Batalioni i Gorës, "Ali Këlmendi", "Çlirimi", "i Mokrës", "Skënder Çaçi", "Fuat Babani", "Tomori" dhe "i Vithkuqit". Krijimi dhe organizimi i kësaj force të madhe partizane për luftën kundër okupatorit italian e më vonë atij gjerman rritën më tej aftësitë organizuese e drejtuese të Nexhip Vinçanit, i cili afirmohet si personalitet politik i Ushtrisë Nacionalçlirimtare.

Mori pjesë si delegat në Konferencën e Pezës bashkë me Ymer Dishnicën (kryetar), Pasho Kolanecin dhe Feta Butkën (përfaqësues të nacionalistëve).

Në gusht 1943, në Vithkuq të Korçës formohet Brigada e Parë Sulmuese me mbi 60 % efektiv nga Qarku i Korçës. Ndërsa brigadat e IV-t, XV-të, IX-të, XX-të u formuan vetëm me efektiva nga Qarku i Korçës. Gjithë kjo forcë e madhe ushtarake, e formuar në Qarkun e Korçës tregon më së miri se komandant Nexhipi dhe komisar Pëllumbi, (për hir të së vërtetës) komandonin 1/5 e Ushtrisë NCC të vendit.

Por le të ndalemi tek brigada e IV-t S

e komanduar nga Nexhip Vinçani e Pëllumb Dëshnica.

Rruga luftarake e kësaj brigade është mjaftë e suksesshme. Qysh në formimin e saj më 28.12.1943 ajo nuk u mblodh për t'u inauguruar sepse kishte filluar Operacioni i Madh Armik i Dimrit 1943-'44. Batalionet vinin në qendrën e grumbullimit dhe nuk kishin kohë të rreshtoheshin, por merrnin detyrat luftarake për të ndalur okupatorin gjerman që vinte nga drejtimet e Beratit, luginës së lumit Devoll. Nga drejtimi i Korçës, Kolonjës dhe Pogradecit, komandant e komisar, Nexhipi e Pëllumbi organizuan bashkëveprimin dhe me forcat partizane të Qarkut të Beratit. Luftimet vazhduan kundër forcave armike pjesëmarrëse në operacion për likuidimin e forcave të Brigadës së IV dhe gjithë Qarkut. Në këtë situatë shumë të vështirë të forcave partizane (dimri i egër, mungesa e ushqimeve e veshmbathjes, mjeteve e forcave) u mblodh Shtabi i Forcave dhe të deleguarit për të vendosur. Nën drejtimin e Koçi Xoxes, të deleguarit e Shtabit të Përgjithshëm që ishin prezent vendosën që forcat partizane të shkonin në prapavijat e rretheve të tyre. Në mbledhje merr fjalën edhe komandant Nexhipi, i cili argumentoi dhe bindi Shtabin e të deleguarit, duke marrë përsipër çarjen e rrethimit dhe nxjerrjen e forcave të Brigadës në zonën e lirë partizane të Beratit. Në këtë situatë shumë të vështirë spikati dhe njëherë aftësia dhe talenti i komandant Nexhip Vinçanit, i cili duke dhënë Urdhërin Luftarak për katër batalionet që të kalonin në kundërsulm në tre drejtimet që pengonin avancimin e forcave armike,

me zgjuarsia kapi lartësitë sunduese me drejtim kryesor, sidomos Qafën e Becit. Gjithë forcat partizane kaluan në zonën e lirë të Skraparit.

KOMANDANTI QË MORI PJESË NË 255 DITË LUFTIME DHE BËRI 220 KM RRUGË

Bilanci luftarak i Nexhip Vinçanit është shumë i pasur. Ai mori pjesë në 255 ditë luftime. Është plagosur në luftimet për çlirimin e Pogradecit dhe ka vdekur me plumbin në bark. Komandant Nexhipi ka drejtuar me aftësi të rrallë luftimet që ka zhvilluar Brigada e IV-t S në dy operacionet armike, atë të Dimrit dhe të Qershorit. Ka marrë pjesë në luftimet e Divizionit të I-rë S nga Jugu, Shqipëria e Mesme e deri në Veri, duke përballuar me sukses ofensivën e forcave armike në zonën e Matit e Dibrës. Po kështu dhe në operacionin "Syri i Kaltër", operacionin për çlirimin e Peshkopisë që solli dhe dështimin e forcave gjermane si dhe luftimet në qarkun e Elbasanit në shtator 1944. Por beteja më e lavdishme e forcave të brig. IV-t S ishte ajo për çlirimin e Tiranës, kryeqytetit të Shqipërisë. Brigada e IV-t u caktua të sulmojë në pjesën jugore duke filluar nga Kodra e Kopilit (sot Varrezat e Dëshmorëve të Kombit) e kodrat në jugperëndim të qytetit deri në Kodrat e Kombinatit të Tekstilit. Komandant Nexhipi bënte pjesë në Shtabin Operativ për çlirimin e kryeqytetit. Luftimet e Brigadës së IV-t S ishin shumë të suksesshme.

DIKTATURA IA MOHOI MERITAT GJENERAL VINÇANIT

Pas çlirimit të vendit, për merita të shquara gjatë LANÇ, Nexhip Vinçanit iu dha grada Gjeneral-Major. U dërgua në Akademinë ushtarake të Shtabit të Përgjithshëm "Voroshilov". Caktohet Zëvendës Shef i Shtabit të Përgjithshëm dhe më 1956 Komandant i Mbrojtjes Bregdetare. Mirëpo, gjithë vlerat e gjeneral Vinçanit, pas çlirimit filluan të zbehën dhe të mohohen. Nga diktatura e Enver Hoxhës dënohet padrejtësisht. Njëkohësisht dhe familja e Nexhipit, Karemanit, Aliut, Skënderit, Samiut dhe Saliut u persekutuan nga sistemi i diktaturës. Vetë Nexhipi burgoset dhe mbahet një vit në hetuesi. Më vonë internohet në Gramsh në një kasolle pylli. Vuajtjet në burg dhe internimi i shkurtuan jetën.

Vetëm ardhja e demokracisë bëri që gjenerali i talentuar Nexhip Vinçani të integrohet në jetën e pakët që i kishte mbetur. Në një nga përvjetorët e Brig. IV-t në Korçë merr pjesë dhe iu flet bashkëluftëtarëve si komandanti i tyre i dikurshëm, i mohuar nga diktatura hoxhiste.

Nexhipi është nismëtar i krijimit të Organizatës të Bashkuar të Veteranëve të LANÇ (OBVL) dhe si anëtar i kryesisë dha një kontribut të shquar në forcimin e saj. Vdiq në Tiranë më 06.02.1977 duke lënë për historinë e brezat veprën dhe emrin e tij. Nder dhe lavdi komandantit, gjeneralit të talentuar Nexhip Vinçani.

**Ish – partizan i Brig. IV-t S, Nënkryetar i OBVL*

STUDIMI

Me rastin e 76 vjetorit të Brigadës së I-rë Sulmuese - “Heroinë e Popullit”

Njësia e parë e madhe dhe e organizuar e Ushtrisë Nacionalçlirimtare Shqiptare

Udhëzimet për krijimin e Brigadës së I-rë u lëshuan më 20 qershor 1943. Pikësynimi ishte që krijimin i këtij formacioni të parë të madh të shërbente për t'i dhënë vrull krijimit të batalioneve e brigadave të tjera, të një ushtrie të rregullt partizane, të cilat do të ngjallnin një besim të madh për zhvillimin e luftës sonë, drejt Kryengritjes së Përgjithshme.

Me krijimin e Shtabit të Përgjithshëm u hodhën themelet e Ushtrisë së rregullt popullore shqiptare. Brigada e I-rë ishte i pari formacion i madh i kësaj ushtrie të rregullt. Kjo brigadë nuk ishte një repart krahine ose qarku, siç ishin çetat, batalionet dhe grupet. Ajo ishte një njësi luftarake në dorë të Shtabit të Përgjithshëm, me partizanë nga të gjitha qarqet e vendit, që do të luftonte, lëvizte dhe manovronte në të gjitha krahinat e Shqipërisë, ku të paraqitej nevoja.

Brigadës së I-rë, si formacion i madh i ushtrisë së rregullt partizane ju ngarkua nga Shtabi i Përgjithshëm detyra që të shërbente si shembull për repartet partizane të të gjitha krahinave, për shndërrimin e tyre në formacione të rregullta. Pra, Shtabi i Përgjithshëm i kishte marrë të gjitha masat politike e organizative që Brigada e I-rë të bëhej me të vërtetë bërthama e shëndoshë për ushtrinë e rregullt.

Të gjitha qarqet e Shqipërisë kishin marrë udhëzime që kontingjentet e caktuara të ishin partizanë e kuadro me përvojë luftarake.

Qarqet e Korçës, Gjirokastrës, Elbasanit e Vlorës do të dërgonin grupet me numër më të madh partizanësh e kuadrosh. Shtabi i Përgjithshëm synonte që kjo njësi të organizohej, paisej dhe plotësohej me një efektiv të pathyeshëm dhe të drejtuar nga kuadro me përvojë ushtarake e revolucionare të lartë, për të përballuar goditje nga më të fuqishmet që do të organizonte armiku. Ky sulm i okupatorit ishte në planin e tij strategjik me qëllim që të pengonte me çdo kusht shkallëzimin e mëtejshëm organizativ e numerik të një ushtrie të rregullt Nacionalçlirimtare

• Rruga luftarake e Brigadës së I-rë Sulmuese, ashtu si e çdo reparti e njësie të Ushtrisë Nacionalçlirimtare të Shqipërisë është e mbushur me vepra heroizmi, vetmohimi dhe besnikërie të pakufishme ndaj popullit dhe Atdheut. Jeta dhe veprimtaria e saj është aq e pasur me ngjarje dhe vepra revolucionare, politike e ushtarake të cilat kurrësesi nuk mund të përshkruhen në një artikull, në një apo dy libra, por në shumë vëllime



shqiptare. Këtë qëllim armiku e tregoi dhe në ditët e inagurimit të Brigadës së I-rë duke angazhuar 10 000 trupa me paisjet luftarake më moderne të kohës, plus forcave të Ballit, milicisë, aviacionit etj, për ta asgjësuar atë që në krijimin e saj.

ORGANIZIMI I NJËSISË

Shtabi i Përgjithshëm zgjodhi vendin më të përshtatshëm, rajonin e Vithkuqit për organizimin e Brigadës së I-rë. Katundi Vithkuq, 20 km në jugperëndim të Korçës, terren malor, ishte i përshtatshëm për të organizuar mbrojtjen. Popullsia e Vithkuqit dhe e fshatrave për rreth ishte 100 përqind në mbështetje të Luftës

Antifashiste Nacionalçlirimtare.

Grumbullimi i grupeve partizane të ardhura nga drejtimet e caktuara filloj që në fundin e muajit korrik '43. Të parat erdhën forcat e Korçës (rreth 200 partizanë e kuadro) të cilat u vendosën në Manastirin e Shën Pjetrit. Më vonë mbritti grupimi i Gjirokastrës që zuri vend në Pyllin e Shtyllës. Deri më 2 gusht mbrritën të organizuar edhe vullnetarët partizanë të qarqeve të Elbasanit, Beratit e Vlorës. Partizanët të veçantë pati dhe nga Tirana, Dibra, Durrësi, Kukësi e Shkodra. Në efektivin e Brigadës I-rë erdhën dhe dhjetë vajza partizane. Në fillim Brigada pati një efektiv prej 556 partizanë. Midis tyre 70 kishin qenë kuadro drejtuese si komandantë e komisarë batalionesh e çetash, komandantë njësitësh guerile, me përvojë të pasur luftarake e të kalitur në vështirësi. JNë datën 10 gusht përfundoi organizimi i Brigadës me katër batalione dhe tre kompani: një kompani mortajash, një kompani pushk kundërtank dhe një bateri artilerie. Një vëmendje e posaçme iu kushtua shërbimit të intendencës. Shtabi i Përgjithshëm për këtë shërbim kishte parasysh se Njësia do të lëvizte nga një krahinë në tjetrën, herëherë me shpejtësi të madhe. Kuptohet që Brigada duhet të kishte një furnizim dinamik, sidomos me municione. Prandaj ndërtimi i këtij shërbimi u organizua në përshtatje me kërkesat e detyrat e Njesisë. Një përforcim i veçantë ju bë intendencave të batalioneve.

15 GUSHT 1943 - DITA E INAGURIMIT

Po afrohej 15 gushti, dita e inagurimit. Ceremonia do të zhvillohej në fushën e vogël të Makërzës, që shtrihet në luginën midis kodrave e pyjeve.

Në Vithkuq prej dy javësh qëndronte Shtabi i Përgjithshëm dhe udhëheqës të tjerë të Luftës. Qarkori i Korçës kishte

marrë të gjitha masat përgaditore për festën dhe mbrojtjen e nevojshme me forcat e vendit. Në sheshin e Makërzës ishin vendosur banderola, flamuj e parulla të ndryshme dhe në qendër tribuna me gjethe e mjete rrethanore. Që në orët e para po vinin aktivistë të fshatrave e qyteteve si nga Korça, Pogradeci, Erseka, Devolli etj. Në orën 9.00 u rreshtuan para tribunës katër batalionet dhe repartet e armëve të rënda me të gjitha pajimet dhe armatimet e tyre. Në mëndjet dhe zemrat e gjithë efektivit të Brigadës ndjehej një gëzim dhe gjallërim i pakufijshëm. Ishte nder i madh të bëje pjesë në këtë brigadë, që ishte njësia e parë e madhe dhe e organizuar e Ushtrisë së rregullt Nacionalçlirimtare shqiptare. Në sytë e sejcilit lexohe gëzimin, krenarinë dhe vendosmërinë për t'i kryer detyrat luftarake deri në vetëflijim.

Të gjithë prisnin me padurim fillimin e ceremonisë. Në orën 10 mbrritën udhëheqësit e PK me E.Hoxhën në krye dhe të Shtabit të Përgjithshëm, të cilët zunë vend në tribunë.

Ceremonia u hap me hymnin e flamurit, kënduar nga kori. Pastaj e mori fjalën Spiro Moisiu, Komandant i Shtabit të Përgjithshëm i cili përshëndeti në emër të Shtabit të Përgjithshëm, duke dorëzuar flamurin në formë trekëndëshi me shkëmbin dykrenare dhe me yllin e artë, me mbishkrimin: “Brigada e I-rë e Ushtrisë Nacionalçlirimtare”. Ai u shpreh: “Ju dorëzoi këtë flamur në emër të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë dhe kam porosi prej tij t’ju them që të mos e lini kurrë të bjerë në duart e armikut, por ta ngrini gjithmonë lart e ta çoni nga fitorja në fitore”.

Komandanti i Brigadës, shoku Mehmet Shehu e mori flamurin dhe në emër të luftëtarëve bëri betimin përpara Shtabit të Përgjithshëm me fjalët: “Betohej se këtë flamur që na dorëzoi Shtabi i Përgjithshëm do ta mbajmë kurdoherë lart. Do të jemi besnikë ndaj popullit dhe do të zhvillojmë luftë të paepur kundër fashizmit okupator dhe armiqve të popullit, për krijimin e një Shqipërie të lirë dhe demokratike popullore”. Këtyre fjalëve ju bënë jehonë zërat e njëkohshëm dhe të zjarrtë të partizanëve: “Betohejmi”. Gjithë sheshi gjëmoi nga duartrokitjet dhe thirrjet e të pranishmëve “Rroftë Brigada e I-rë Sulmuese” etj. Në këtë ceremoni folën oratorë të ndryshëm.

Ceremonia u mbyll me parakalimin e Brigadës. Në fushë nuk ndjehej asgjë përveç hapit luftarak të partizanëve. Oshtëmta e hapit përcillej larg nëpër pyje e male. Pas ceremonisë, deri vonë në mbrëmje buçitën këngët dhe vallet partizane...

Efektivi i Brigadës së I-rë pati vazhdimisht ndryshime. Më 8 tetor Brigadës iu shtuan edhe 150 partizanë italianë, të cilët formuan Batalionin “Antonio Gramsci” dhe në fund të marsit ‘44 u shtua edhe batalioni i 5-të. Brigada arriti kështu një efektiv prej 1237 luftëtarësh.

POGRADECI – qyteti i luleve, i pushkës dhe i penës

(Vijon nga faqja 2)

Rëzes, Mokrës së Poshtme, Golikut etj.

Batalioni partizan i Mokrës ka zhvilluar shumë aksione dhe luftime kundra pushtuesit, por veçanërisht është evidente pjesëmarrja në luftimet e Brigadës IV-t për çlirimin e Pogradecit. Qyteti i Pogradecit është çliruar tre herë nga forcat partizane: më 17-18 prill 1944; më 4 qershor nga forcat e Brigadës së IV-t dhe përfundimisht më 30 gusht 1944 nga forcat partizane të Brigadës së XV-të S. Populli e priti më gëzim të madh këtë ngjarje historike dhe manifestoi nëpër rrugët e qytetit për fitoren e madhe të çlirimit të tij njëherë e përgjithmonë nga pushtuesit. Çlirimtarët në mbrëmje u ndanë nëpër baza për të kaluar këtë natë të gëzueshme, me më shumë ushqime, sipas zakonit.

Kontributi i Ushtrisë Nacionalçlirimtare Shqiptare është një monument i madh i historisë sonë në Luftën e Dytë Botërore. Pa luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare, Shqipëria nuk do të ekzistonte si shtet sovran dhe i pavarur. Kjo luftë na rrjeshtoi përbri fitimtarëve, aleatëve të mëdhenj si SHBA, Bashkimi Sovjetik dhe Britania e Madhe. Rrethi i Pogradecit mori pjesë masivisht në këtë luftë dhe i dha atdheut 1582 luftëtarë të armatosur në formacionet luftarake. Nga këta 144 dëshmorë, në altarin e nderit që dhanë jetën për çlirimin e atdheut dhe dy Heronj të Popullit, komandantët Reshit Çollaku dhe Kajo Karafili.

Në këtë 75 vjetor të çlirimit, populli i pogradecit i kujton ata me nderim të veçantë.

Ing.Myfit GUXHOLLI
Veteran – nënkryetar i OBVL

PROFIL

Ali Mus Lushaj vazhdon të përmendet me respekt edhe sot nga të gjithë ata që e kanë njohur

Shoqëria ka nevojë gjithmonë për burra fisnikë e shërbëtorë të dëvotshëm

Ismet Balaj, studiues

Ali Mus Lushaj ishte njeri nga këta. Ai u lind më 1928 në Shipshan të Malësisë së Gjakovës -Tropojës. Është i një familje me një histori që kushdo që ta kishte do të ndjehej mirë e ballëndritur përpara të tjerëve. Me jetën dhe veprën e vet në shërbim të shoqërisë shkroi emrin që vazhdon të përmendet me respekt edhe sot nga të gjithë ata që e kanë njohur.

TRADITA

Shekulli i njëzetë ishte shekulli i ngjarjeve të mëdha, veçanërisht për kombin shqiptar. Shipshani e ka ndritur Malësinë e Gjakovës (Tropojën) me vepra në shërbim të atdheut gjatë këtij shekulli. Vëllazëria Lushaj është njëra prej 12 vëllazërive që ka fshati. Gjyshi i Aliut, Zenel Mehmeti, ka marrë pjesë aktive në kryengritjet e mëdha popullore të viteve 1900-1912 në luftë kundër ushtrisë turke. Qëllimi i kësaj lufte ishte çlirimi i Shqipërisë nga pushtimi pësqintvjeçar osman dhe fitorja e Pavarësisë. Në luftimet që u zhvilluan në pranverë-vjeshtë të vitit 1912, ra heroikisht dëshmor i atdheut duke luftuar në Qafë të Morinës. Xhaxhai i tij, Niman Uka, ishte kundërshtar i regjimit të Zogut, sepse ishte përkrahës i forcave demokratike të kohës me Bajram Currin dhe pasuesit e tij. Në këto rrethana, duke kaluar kufirin shtetëror, është vrarë nga forcat serbe duke luftuar me armë në dorë.

Babai i Aliut, Musa, vazhdoi traditën e të atit, Zenelit, në luftërat që u zhvilluan gjatë viteve pas pavarësisë së Shqipërisë. Serbët e malazezët e pushtuan Shqipërinë e Veriut gjatë viteve 1912-1915. Lufta ishte e pabarabartë në forca e mjete, por edhe qëndresa shqiptare anëkend vendit ishte e fortë. Edhe në këtë periudhë sakrificash të mëdha, ku gjithë Kosova e bashkë me të edhe Malësia e Gjakovës u bë një kasaphanë, ku u vranë me mijëra njerëz e u dogjën dhjetëra fshatra. Qëndresa e Shipshanit ishte e madhe. Ndër luftëtarët e tij, u shqua edhe Mus Zeneli. Po ende pa mbaruar një luftë e një pushtim, Austrohungaria, mbasi pushtoi Serbinë me 1914-e në vazhdim më 1916-1918, kishte "radhën" e pushtimit të Shqipërisë për interesat e veta perandorake. Kudo vendosi një regjim të egër, por edhe kundërshtimi ndaj pushtuesve të rinj ishte i pandalshëm. Puna angari, mobilizimi ushtarak, marrja me forcë e drithërave të bukës dhe e bagëtisë për furnizimin e ushtrisë ishin disa nga masat e padurueshme, prandaj kudo shpërthyen revolta mbarëpopullore. Ndër kundërshtarët e kësaj shtypje të re u ngrit, edhe me luftat e tjerë edhe Musa, i cili edhe u zu rob bashkë me dhjetëra malësorë të Tropojës, edhe të Kosovës. Për siguri u dërguan në Zhur-afër Prizrenit, ku kishte përgatitur kampin e përqendrimit të kundërshtarëve. Në kujtesën e njerëzve është regjistruar kjo kohë e vështirë vuajtje e mjerimi si "koha e Nëmcsës, (Gjermanisë)".

Mbas Luftës së Parë Botërore ai bashkë me të tjerë, u bë luftëtar për liri e përparim të Shqipërisë. Mori pjesë në lëvizjet për demokraci e zhvillim gjatë viteve 1920-1925 si idhtar i Bajram Currit, Hasan Prishtinës e të tjerë udhëheqës të mëdhenj të Kombit. Për këtë dha kontributin e tij për fitoren e forcave demokratike në Revolucionin Demokratik borgjez të vitit 1924. Me dështimin e tij, vazhdoi të



ishte në opozitë të qeverisë të kryesuar nga Ahmet Zogu, që, i ndihmuar nga Serbia, u rikthye në Shqipëri në dhjetor 1924 dhe u vu në krye të shtetit shqiptar për afro 15 vite si kryetar shteti e pastaj mbret i shqiptarëve. Qeveria gjatë kësaj kohe vendosi kudo një regjim të rreptë. Përndjekja e opozitarëve ishte një nga drejtimet e veprimtarisë gjatë gjithë kohës së qeverisjes. Kështu edhe vëllazëria Lushaj u ndodh gjithnjë e përndjekur. Në këto rrethana, xhaxhai i Aliut, Niman Uka, u detyrua që të largohet nga Shqipëria e të emigroi në Jugosllavi. Por në përpjekje me forcat ushtarake serbe në kufi, u vra nga rojet kufitare të Serbisë.

ALIU.....

Në këtë truall të begatë qëndrese e ngjarjesh të dhimbshme u lind, u rrit dhe u edukua Ali Mus Lushaj. Në odat e burrave ku zhvilloheshin kuvende për probleme të ndryshme, kryesisht patriotike, se si të çliroheshin nga shtypja e egër dhe shfrytëzimi i pa shpirt i një regjimi anadollak feudalo-çifligarë, ai mësoi se rruga e vetme ishte pjesëmarrja në lëvizjet e organizuara për demokraci. Pushtimi i Shqipërisë nga Italia fashiste e nxiti edhe më shumë shpirtin e të riut Ali Lushaj, që të aktivizohej si të parët e tij në fillim të shekullit, edhe ai në luftën e re antifashiste që kishte marrë përsipër çlirimin e atdheut nga çdo pushtues dhe vendosjen e një rendi demokratik. Ai e kuptoi se pa çlirimin e Shqipërisë nga pushtuesit, nuk mund të kishte as zhvillim e as përparim demokratik. Në këto kushte morën "udhë" dhe u kaliten tiparet themelore, virtytet që do ta shoqëronin gjithë jetën.

Në moshë ende pas mbushur 15 vite jetë, merr pjesë aktive në luftën e malësisë së Gjakovës-Tropojës për çlirimin e qytetit të Gjakovës nga pushtuesit italianë, më 6 shtator 1943. Këtu mësoi mirë dhe provoi për herë të parë se liria e demokracia mund të vinin vetëm nga lufta e përbashkët e të gjithë shqiptarëve kundër të huajve. Pikërisht këtu u pagëzua si luftëtar i lirisë dhe hyri në batalionin partizan "Rinia" që u themelua në nëntor të këtij viti. Me krijimin e batalionit partizan "Bajram Curri" u bë luftëtar i tij. Duke qenë partizan i këtij batalioni, mori pjesë në një seri aksionesh që ky batalion zhvilloi gjatë viteve 1943-1944, si kundër operacionit gjerman të shkurtit 1944 që u zhvillua në

gjithë rrethin e Tropojës, e veçanërisht në Bujan dhe Degë; aksione kundër gjermanëve që u zhvilluan në zonën Pejë-Gjakovë gjatë verës së vitit 1944; në aksionin për çlirimin e minierës së Kamit nga pushtuesit gjermanë, të cilët e shfrytëzonin për interesa të armatimit të luftës me robër të nacionaliteteve të ndryshme nga Ballkani, shtator 1944 etj. Me krijimin e Brigadës së XV Partizane Sulmuese në nëntor 1944 me çlirimin e Tropojës, Ali Lushaj rreshtohet në radhët e saj, pastaj disa nga partizanët e kësaj brigade, një ndër ta ishte edhe Aliu, u inkuadruan në Brigadën e III Partizane Sulmuese (e Tiranës). Si një nga partizanët më të rinj të kësaj brigade, ai përballoi udhëtimin e gjatë e të vështirë gjatë dimrit 1944-1945 në Kosovë dhe deri në Sanxhak të Bosnjës. Ky udhëtim prej më shumë se njëmijë kilometra në kushte dimri, bore e të ftofti të acartë, nuk e mposhtë në riun e partizanin Ali Musa. Përkundrazi, duke qenë bashkë me shokë në llogore lufte, të veshur e të mbathur keq; pa prapavi që t'i furnizonte me ushqim minimal për të jetuar e përballuar kohën e luftës dhe vështirësitë ishte problem shumë i madh i kohës; në kushte ushqimi duke ngrënë një herë në 24 orë nëpër shtëpitë e shqiptarëve të Kosovës, por edhe të Sanxhakut të Bosnjës, ata e mbajtwn edhe me patate të mërdhira, të ziera vetëm me uj. Sa edhe lufta, u bë rrezik jete edhe përhapja e sëmundjes se tifosë së morrit të kuq, që solli jo pak vdekje, çka vinte nga kushtet e vështira të higjienës në ato ditë dimri. Kështu Ali Lushaj u kalit, karakteri i tij u bë qëndrestar përpara çdo situatë. Ai kishte si prinjës idealet e të atit, te xhaxhait e të gjyshit, por edhe të partizanëve, të shokëve që i kishte në krah natë e ditë, nga ora në orë, nga dita në ditë në këtë marrshim e përballje me ushtritë gjermanë, ... Si shkollë të parë në këtë fushë të jetës pati ushtrinë Nacional Çlirimtare. Gjithnjë jetoi me rrezikun e vrasjes nga çasti në çast, aq sa dikur as që çante kokën se cili do të ishte fundi i tij, ashtu si shokët e tij, veç populli shqiptar të fitonte e të garantonte lirinë.

Në kohë pushimi, por edhe gjatë natës nëpër shtëpitë, ku partizanët ndaheshin nga kryepjeqët për të kaluar natën, Ali Lushaj mësoi të shkruajë e të lexojë nën dritën e zbehtë të një bishtuku. Kështu ai provoi edhe vetën se sa i fortë ishte në këtë moshë rinie të hershme. Kuptoi se për të fituar, për të përparuar duhet qëndresë, besim, shpresë e veprim me guxim për arritjen e qëllimeve.

Liria u fitua me grykën e pushkës të partizanëve luftëtarë. Filloi një epokë e re për shqiptarët. Punuan dhe jetuan me besim e shpresë për një të ardhme më të mirë. Disa prej ish partizanëve, u bënë administratorët e parë të periudhës së pasçlirimt. Ndër këta ishte edhe Ali Lushaj. Fillimisht ai u mor me rindërtimin e vendit, organizimin e rinise për kryerjen e aksioneve të ndryshme që kërkonte periudha. Përvoja e luftës ishte e madhe.

Çdo gjë mund të fitohet me besim, shpresë e, guxim e veprim, duke mos kursyer as shëndetin, as kohën, as moshën ende të re. Bashkë me rininë e fshatit, ndihmuar familjet pa krahë pune e në varfëri ekstreme atëherë kur këto përfshinin shumicën e shtëpive të fshatit. U meremetuan ura, u hapen rrugë të fshatit e të bjeshkëve, zgjeruan dhe rregulluan rrugën për në Gjakovë e për në qëndër të rrethit që ishte Tropoja në vitet e para. Aliu, duke përfutur nga përvoja e luftës, ishte një akcionista i dalluar. Në ndërtimin e rrugës

Kukës-Peshkopi (1947-1948 ishte një komisar që drejtonte jo me zhurmë e bujë, por me mend dhe shembull konkret, me parimin: Kështu duhet punuar, hajde të punojmë bashkë. Duke u prirë të tjerëve, të tjerët e ndoqën pas. Ai fitoi respektin dhe dashurinë e shokëve akcionista. Edhe aksionet vullnetare ishin shkolla formimi dhe edukimi, shkolla përgatitje për të punuar sa më mirë e për të jetuar me nder e fisnikëri.

Natyrisht punët dhe detyrat që kreu Ali Lushaj pothuaj gjatë gjithë gjysmës së dytë të shekullit të kaluar, nuk është e nevojshme t'i listojmë ato, prandaj dua të veçoj disa nga më të rëndësishmet.

1. Ishte drejtori i parë i bankës në qytetin Bajram Curri në vitet. Gjatë kësaj periudhe ai jo vetëm e vuri mbi baza e kritere shkencore, si gjithë bankat e tjera në Shqipëri, por organizoi një njohje të mirë në popull të mundësive që u afronte banka për kreditimin e qytetarëve të ndryshëm për ndërtim shtëpiash, për blerje bagëties, për ngritje e hapje dyqanesh dhe afrimin e kredive për të mundur zhvillimin me ritme të mira në ngjitje të ekonomisë së tregut të vogël e të mesëm. Në këto vite për herë të parë morën kredi edhe shumë fshatarë, të cilët ndërtuan shtëpi të reja, shtëpi të cilat qëndrojnë edhe sot. Banka u kërkonte atëherë projektin duke pasur parasysh kërkesat e reja për shtëpi një katesh të tipit Elbasan, si edhe të ndërtimeve dy katesh, duke mos lejuar përdorimin e katit të parë për mbajtjen e bagëtive. Kjo ndikonte në formimin e një koncepti të ri për higjienë dhe pastërtinë edhe në familjet fshatare.

2. Po kështu disa vite ka qenë Kryetar i Kooperativës së Artizanatit të rrethit. Nga tre reparte, si rrobaqepësi, këpucari, berberë, hapi edhe të reja, si ai përpunimit të frutave, si reçel, pekmes, marmalatë, të pijeve alkoolike, gështënjës, etj. Në këtë kohë po bëhej një përpjekje për përhapjen e zakonave të reja, në luftë kundër zakoneve të vjetruara, vëmendjen e përqendroi edhe në veshmbathjen e njerëzve. Tropojanët jetojnë në një vend malor dhe me klimë të ashpër, prandaj mbanin gjatë tërë vitit edhe rroba të lesh-ta, shumica e të cilave pasi përpunoheshin në vanica, dilnin të trasha, të nxehta e të rënda. Po me rroba të tilla dilnin edhe ne punë gjatë stinës së verës. Për t'i u përgjigjur kushteve të reja u hap edhe repartit i ruajtjes së traditës dhe formimit të traditave të reja në këtë drejtim. U synua që këto rroba për gjatë stinës së verës dhe kohës së punës të zëvendësohen me rroba të linjtë, që ishin edhe me kosto të ulët dhe më higjienike. Njëkohësisht u ngrit edhe repartit i rrobaqepësisë për ruajtjen e traditës, për rroba burrash dhe grashë. Në këtë mënyrë u bë një ndryshim i dukshëm edhe në këtë fushë. Kjo traditë vazhdon edhe sot.

3. Ka qenë edhe Kryetar i Kooperativës Bujqësore të Bashkuar Dragobi, Qerem, Valbonë e Bradozhnicë. Kjo është zonë krejt malore: shumë pyje e shumë pak tokë arë. Në këtë kooperativë gjatë drejtimit prej Ali Lushajt mori zhvillim të vullshëm blegtoaria, sidomos shtimi i tufave me dhi, mbasi për ato kishte ushqim për dimër e për verë gjetet e drurëve të ndryshëm si ah e shkurre.

Për arritje në këtë fushë kjo kooperativë mori edhe flamurin e garave socialiste që zhvilloheshin në ato vite për të nxitur zhvillimin më mëtejshëm të ekonomisë.

REFLEKSIONE

ISUF VESELI (Demaj) dhe KOMITETI “MBROJTJA KOMBËTARE E KOSOVËS”

Kur do të kemi një histori kombëtare të njësuar?

Kadri Tarelli

Si mësues dhe punëtor i lëtrave në histori, mendoj të shpreh e të ndaj me kolegët, një shqetësim: Kur do të kemi një histori kombëtare të njësuar? E them këtë pasi, kur më duhej të përgatisja një fjalë të shkurtër për jetën dhe veprimtarinë e Isuf Veselit, kisha vetëm një foto të pjesëtarëve të Komitetit të “Mbrotjtjes Kombëtare të Kosovës”, të themeluar në Shkodër, në nëntor të vitit 1918. ku jepen emrat e anëtarëve, mes të tjerëve shkruhej emri i Isuf Veselit.

Rilexova edhe një herë tekstet e historisë së Universitetit të Tiranës, disa monografi, si: “Bajram Curri”, të Skënder Drinit, “Hasan Prishtina” të Prof. Dr. Muhamet Pirraku, “Niman Ferizi. Pishtar i arsimit shqip”. Monografi nga Shevqet Canhasi. Të tre veprimtarë të Komitetit. Vazhdoj më tej: “KOSOVA” vështrim monografik, botim i Akademisë së Shkencave dhe arteve të Kosovës, Prishtinë 2011. Më pas shfletova edhe Librin “Komiteti “Mbrotjtja Kombëtare e Kosovës”, (përmbledhje kumtesash). Tiranë, 2004. Mos të themi edhe tekstet e historisë të shkollave të Mesme dhe 9-vjeçare në Republikën e Shqipërisë, ku secili autor punon për qejf të vet. Në emër të reformës së teksteve, kam përshtypjes se, “kërkuam të vemi vetulla.....”, thotë populli.

Çuditërisht, në të gjitha këto libra dhe tekste mësimore nuk jepet përbërja e Komitetit, vetëm përmenden dy ose tre drejtues të njohur, ose asnjëri prej tyre. Të gjitha më shtyjnë të bëj pyetjen, pse? Dhe nuk gjej përgjigje.

Pse janë kursyer për të shtuar edhe 2-3 rreshta më tepër, kur bëhet fjalë për studime drejt për drejt të temës përkatëse? Unë e di nga përvoja, se secili shkruan aq sa di dhe aq sa do, ndaj përgjigjen le ta japin autorët, pasi unë e gjeta zgjidhjen në dy shkrime në internet, ku flitej gjerë e gjatë për krijimin dhe programin e kësaj organizate politike mbarëkombëtare, ku përmendet edhe përbërja e plotë e komitetit.

Për fat të mirë, në të gjitha tekstet publikohet kjo fotografi, por pa emrat e shënuar poshtë. Vetiu lind një pyetje: Ç’vlerë ka kjo foto, kur në tekst nuk janë emrat e pjesëtarëve, në mënyrë që nxënësi, studenti, apo cilido nga ne t’i njohë, mbase edhe të mburret me të parët e tij, të cilët bënë histori?

Historia e fillim shekullit XX, në prag dhe pas shpalljes së Pavarësisë, është shumë e trazuar, për fatin dhe mbijetesën e Shqipërisë dhe shqiptarëve. Lufta Ballkanike, Konferenca e Ambasadorëve në Londër. Lufta e parë botërore, kryengritjet dhe pushimi i trojeve tona nga fqinjët dhe fuqitë ndërluftuese. Viti 2018, habitshëm i lidh bashkë disa ngjarje madhore të historisë së shqiptarëve: Viti i Skënderbeut, heroit ton Kombëtar, në 550-vjetor të vdekjes, 140-vjetor



ri i Lidhjes shqiptare të Prizrenit, 110-vjetori i Alfabetit shqip në Kongresin e Manastirit dhe 100-vjetorin e KMKK.

Për ta bërë të njohur këtë organizatë atdhetare, që unë me bindje e emërtoj: “Qeveri e Kosovës në emigracion”, po citoj:

1. “Ndonëse pagëzimi i organizatës ishte Komiteti i Kosovës, nga pika e parë e programit themelues të kësaj organizate, shihet që nuk ishte qëllim vetëm çlirimi i territoreve të Kosovës, por e tërë territoreve shqiptare të pushtuara nga serbo-malazezët”. Prof. Dr. Lush Culaj. Kumtesa: “Shekulli i Komitetit Mbrotjtja e Kosovës 1918-2018”. Prishtinë: 21, Mars, 2018

2. Pas një debati tri orësh, Komiteti. MKK do të ketë këtë përbërje: Hoxha Kadri Prishtina (kryetar), Hysni Curri (nënkryetar), Halim Gostivari (nënkryetar) dhe Bedri Pejani (sekretar). Anëtarë u zgjodhën: Sali Gjuka, Isuf Veseli, Sadik Ramë Deçani, Neshi Hoxhë Sadiku, Avdush Kastriati, Jahja Begolli, Hamdi Zajmi, Niman Ferizi, Rrok Perrolli, Tahir Zajmi, Kahreman Begolli dhe Ibrahim Gjakova-Çausi. Anëtarët e nderit ishin: Hasan Prishtina (mungonte në takim sepse ishte në Vjenë bashkë me 36 prijës shqiptarë për të vizituar familjen e Franc Jozefit, që kishte vdekur kohë më parë), Bajram Curri, Mehmet Delia, Azem Bejta, Naxhip Draga, Aqif Blyta, Ramë Vllasa, Ilaz Raçaku, Nak Berisha, Dan Doroci. Pa e komentuar, por jo pa qëllim, po citoj një thënie, që na vjen nga lashtësia: Pas një beteje, luftëtarët e quajten “shqiponjë”, komandantin e tyre Pirron e Epirit, dhe ai u a ktheu: “Unë jam shqiponjë, por krahët e mi jeni ju”.

Programi: “Në të gjitha pikat shpreheshin qartë parimet themelore politike e ushtarake të forcave kryengritëse. Në nenet 1, 2, 3, dhe 4, thuhej se kryengritësve shqiptar u ndalohej rreptësisht dhunimi, plaçkitja, djegia e shtëpive, kishave e ndërtesave të tjera si dhe vrasja e

robërve të luftës. Në nenin 12 thuhej se “Nderi i vajzave dhe grave serbe do të mbrohet si nderi i shqiptareve”. Dr. Jahja Lluka. Tema; Të restaurohet shtëpia historike ku u krijua “Komiteti për Mbrotjtjen Kombëtare të Kosovës”. Portali VOAL. Nëntor 06, 2018.

Siç nënvizova më lart, mes anëtarëve të komitetit është edhe Isuf Veseli, për të cilin kanë shkruar edhe të tjerë:

Dr. Muhamet Shatri, në kumtesën e tij: “Të dhëna biografike mbi disa veprimtarë të Komitetit “Mbrotjtja Kombëtare e Kosovës”, shkruan: Bardh Isuf Gashi, bashkë me Isuf Veselin e Kryedrinin (Radavci), e me shumë burra të Podgurit, luftoi me heroizëm kundër ushtrive pushtuese serbo-malazeze. Libri “Komiteti “Mbrotjtja Kombëtare e Kosovës”, (përmbledhje kumtesash). Tiranë, 2004. Faqe. 175-175. Botuar nga Akademia e shkencave e Shqipërisë. Instituti i Historisë - Tiranë. Instituti i historisë - Prishtinë.

Bajram Halil Gashi, në librin e tij “Ah Shqipni... mos thuj mbarova”, kushtuar legjendës së folklorit shqiptar, Dervish Shaqa, Demush Neziri dhe grupi kosovar. Ku pasi vendos fotografinë, e cila flet më shumë se një libër, të cilën e ndeshim gati në të gjitha shkrimet dhe botimet, kushtuar Komitetit MKK, kur shkruan për odën e burrave, thotë:

Isuf Veseli është nga Radavci i Komunës së Pejës. Ishte bashkëluftëtar me Haxhi Zekën. Të dy këta luftëtarë ishin tmerri i Turqisë dhe për shovinistët serb. Ai ishte dënuar me vdekje nga Turqia. Pjestarë të kësaj familje: djali Vesel Beka, vëllai Mehmet Veseli, ishin internuar në Turqi për veprimtari kombëtare.

Haxhi Zeka, selinë e tij e kishte në kullën e Isufit. Aty u bënë shumë kuvende, besatime e tubime, besëlidhje e pajtim gjaqesh. Të gjitha lëvizjet patriotike gjatë atyre viteve, zanafillën e kishin në kullën e Isuf Veselit.

Një ngjarje e ruajtur në gojdh-

na: Tek po rruhej, Haxhi Zeka po i thotë Isufit: “Isuf! Shkijet, s’don me ma lan vendin kund, po don me më vra. Në më vrafshin, qe besa, Kosova mbet’ nën Serbi. Edhe në u çlirofshi, e serbin kojshi, bythën rehat prej Serbije, s’keni me e ba”.

Ushtria serbe kishte pësuar disfatë në vendkalimin e Xhlep-it. Luftëtarët shqiptar, me në krye Isuf Veselin, kishin ba kërdrinë në serb. Pas kësaj disfate, pushtuesi serb, nën komandën e Velashkov-icit, për hakmarrje kërkon kokën e Isufit, por ai jo vetëm e shpërfill, por edhe e kërcënon, duke i dërguar ultimatumin, se “Lufta kundër teje ende s’ka fillue”. Për pasojë të qëndrimit dhe të kundërshtimit, fillojnë bombardimet e kullës me gjyle topi. Kulla shkatërrohet tërësisht deri në themel, duke i vënë zjarrin dhe duke lënë në qiell të hapur dhjetra familjarë të familjes së madhe të shtëpisë “Veseli”.

Kjo përforcohet nga Dr. Nevila Nika, në kumtesën: “Hoxha Kadri Prishtina-Kryetari i Komitetit “Mbrotjtja Kombëtare e Kosovës”. Ajo shkruan:

- Hoxha Kadriu, letër proteste, më: 12. Shkurt, 1921, drejtuar Ministrive të Punëve të Jashtme të Fuqive të Mëdha dhe Lidhjes së Kombeve: “.... Serbia pushtoi Kosoven për herë të dytë dhe me qëllim që të humbasë racën shqiptare, ndoqi një politikë shumë të egër. Burgjet u mbushë plot me shqiptarë, gjithë katundet e krahinave Podgor e Rugovë të Pejës, i dogji dhe i shkatërroj, një pjesë të popullsisë e vrau dhe ata që mbetën, i detyroi të arratisen maleve, ose në mërgim”. Kumtesë. Libri. Komiteti “Mbrotjtja Kombëtare e Kosovës”. Përmbledhje kumtesash. Akademia e shkencave Tiranë. 1984. Faqe 177.

Ishte ky qendrim dhe këto veprime luftarake të kaherëshme të tij, që Isuf Veselin e bënë të njohur në mbarë Kosovën, prandaj ai ishte zgjedhur anëtar i Komitetit “Mbrotjtja kombëtare e Kosovës”, që ishte një ngjarje madhore për kohën. Isuf Veseli (Demaj), vdes në vitin 1936, por shtëpia e madhe pati plot burra të vyer. Aktiviteti i tij atdhetar, u vazhdua nga pasardhësit e tij.

Kur përmenda këta heronj të shqiptarisë, mendoj: Cilido nga ne do ta kishte lakmi, që t’i kujtohej emri dhe vepra edhe mbas 100-vjetësh, siç solla këtu, diçka nga jeta dhe vepra e Isuf Veselit.

Historia e shqiptarëve po na mëson, se liria nuk dhurohet, por fitohet dhe, lufta, gjaku dhe përpjekjet qindra-vjeçare të atdhetarëve të përkushtuar për komb e flamur, solli përmbushjen e gjysmës së detyrës dhe dëshirës: Çlirimin e Kosovës. Ndërsa brezat, do ta përmbushin ëndrrën: bashkimin e Kombit. Paçim fat dhe jetë që ta shijojmë edhe ne!

Në mbyllje, po kujtoj porosinë e Bedri Pejani: “Mosni djema! Nuk zgjidhet çështja shqiptare në bashkëpunim me serbo-sllavët”.

PROFIL

Dod N. Luli i dhuron qytetit të Fushë-Arrësit një memorial madhështor historik kushtuar Dr. Terenc Toçit me “Qeverinë e Kimzës” të drejtuar prej tij, 1911.

“Qeveria e Përkohshme e Kimzës”

Xhemal Meçi

Studiues, “Mjeshtër i Madh”

1-Dod Nikollë Luli, një biznesmen modest, por me shpirt të madh për të pasqyruar vlerat etnokulturore e historike të vendlindjes, Lumziut të Spaçit të Mirditës e më gjerë; më 18 qershor 2019 i dhuroi qytetit të Fushë-Arrësit të rrethit Pukë memorialin historik madhështor “Qeveria e Përkohshme e Kimzës” me të 22 anëtarët e saj të kryesuar prej atdhetarit arbresh Dr. Terenc Toçi.

2.Përgatitja e memorialit dhe vendosja e tij në pedestal i ka kushtuar dhjetra mijëra ero, por është i kënaqur që ia arriti këtij qëllimi në prani të qindra arstorëve e pukas si dhe të ftuar prej Tirane, Shkodre, Malësisë e Madhe, Dukagjini, Nikaj – Merturi,deri prej Rome e SHBA (USA).

Parasëgjithash, duhet parë qoftë edhe përmbledhtas kuadri historik për kohën kur erdhi ky atdhetar i shquar arbresh për të kryer një mision të madh historik, për të ndihmuar kryengritjet antiosmane në shkallë kombëtare deri në çlirimin e plotë të Shqipërisë, të Atdheut Amë, siç e quante ai Shqipërinë, Atdheun e të parëve të tij arbëreshë.

Vitet 1909, 1910 u shoqëruan me kryengritje të fuqishme antiosmane, të drejtuara prej atdhetarëve: Idriz Seferi, Isa Boletini, Sylejman Vokshi, Haxhi Rrustë Kabashi etj. Kryengritjet u sulmuan prej mijëra ushtarësh osman me armët më moderne të kohës, deri me artileri malore, që dogjën e shkretnuan fshatra të shumtë, sidomos në Kosovë. Shefqet Turgut Pasha sulmoi barbarisht në luginën e Kaçanikut,fshatra mbarë të kësaj luge, duke pasë nën armë 40 mijë forca ushtarake.

Këto i shprehin edhe këngët historike të asaj kohe:

1. “Na u nis pushka n’ Kaçanik,/Tuj luftue nat’e dit!/
Kaçanik he të raft pika! / Që s’po din ç’ka asht hika! / 6 sahat t’u ther me thika. / Me thika n’dor’ 6 sahat, / Deri sa notoi kali në gjak”.

2. “Turgut Pasha me ushtri, / Isa Begi me shqiptari, / N’Carnalevë s’le turk me hil”.

3. “Ka shkue zani n’at Mirditë, / Dy mijë trima kanë dalë komitë, / Se s’janë msue me u koritë / Hajt, Mirditë, të dalt naml! / Në shtat krajla t’ka shkue zani”!

4. “Kuvendon Krajli me Mbret”:/ - A ka Puka hyqymet, / Që s’ e ban zap atë milet!

5. “Halil Musa me Zenel Agen 2000 pukas te i kan bashkue, / N’ Shehrit t’ Shkodrës na i kan shti për me i hek kto petkazi, / Se lypin taksa e askeri ç’ ka s’ ka qen ndojher në Malsi”!

“N’at Stamboll po kndon gazeta: / S’i nep armët Ndoc Mark Deda. / -Besa, armët nuk i nap, / Për pa i la zaptijet n’gjak, / Për pa i vra çata zapti, / Se ktu i thonë Berishë me Pukë e Malsi”.

6. “Mark Koliku nuk bjen n’dorë pa perzie gjak me borë! / Bashkë me çetë me armë në dorë



Kështu, Brigjet e Iballes: Berishë, Mertur, Mzi, Dardhë kishin formuar dhjetë çeta luftëtarësh, që e mbanin zonën të çliruar e të mbrojtur.

Kjo situatë kryengritjesh ishte mbështetëse për veprën e Dr. Terenc Toçi, i cili i gjeti Malet e Veriut të gatshëm për kryengritje të përgjithshme antiosmane. Prandaj ndjeu frymëzim e shtytje për misionin e tij historik për çlirimin e pavarësimin e Shqipërisë së robëruar. Kështu, i vendosur e me vullnet të jashtëzakonshëm i përndritshmi Dr. Terenc Toçi zbarkoi në brigjet e Malit të Zi, kaloi nga Cetina, ku bashkoi rreth vetës revolucionarët shqiptarë, të gatshëm për përkrahje të Terenc Toçit, si: Kolë Marka Kola, Gjemarkaj me qëndrim në Cetinë, i cili u tregua i gatshëm duke i dhënë shoqërues edhe sekretarin e tij besnik Zef Shantojen nga Shkodra.

I kënaqur nga kjo pritje e siguria, u ngjiti maleve: në Malësinë e Madhe, Dukagjin e Nikaj-Mertur, derisa kaloi Drinin dhe hyri në Bugjon, ku e prit vëllazërisht Frrok Bajraktari i Thaçit. Pritja aq e ngrohtë dhe e përzemërt sikur e çlodhi dhe e çliroi nga ai udhëtim i vështirë përmes shtigjeve shkëmbore

me borë e akull, derisa kaloi Drinin e hyri në viset e Pukës, ku u mirëprit bujarisht.

Si u çlodh dhe mori bekimin dhe premtimin e Thaçit, bashkë me bajraktarin e tij trim e besnik, Frrok Bajraktarin e shoqëruesit nga Mbishkodra e Nikaj-Mertur, trokiti në kullën historike të bajraktarit të Berishës, Prend Uka, burrë kreshnik e fisnik, bujar e kanunar i urtë e trim, i mbrojtur prej çetës së Ndoc Mark Dedës e vëllezërve të tij, bashkë me çetën e Mark Kolikut të Berishës Eper e rrethinë.

Dr. Terenc Toçi, i fuqizuar dhe i ushqyer shpirtërisht u nis për në Fan të Mirditës, ku në Klos festohej me miq më 24 e 25 prill festa e Shën Markut, ku zhvillohej edhe një panair pranveror bashkë me Lurë, Lumë pjesërisht dhe Dibër e Pukë.

Gjatë udhëtimit për siguri kaloi mbi Kabash e Bicaj, ku mori premtime edhe nga bajraktarët e Kabashit e të Pukës: Vocërr Bajraktari e Halil Musa.

Dr. Terenc Toçi, i gëzuar sa s’ka nga bashkimi myslimanë e katolikë në Pukë, si dhe lidhjet e ngushta Pukë-Mirditë, siç thonin vëzhgues të huaj kalimtarë: “Pukë e Mirditë-gjithmonë aleatë”.

I siguruar prej trimave të Thaçit e të Berishës, arriti mirë e shëndosh në Klos të Fanit natën e Shmarkut, ku kishin filluar të vinin miq të shumtë që brohorisnin ardhjen e Dr. Terenc Toçit në vatrën e tyre bri lumit Fan, “Në zemër të Shqipërisë”. Më 26 prill në një kuvend të madh, mbajti fjalimin shumë emocionues: “vëllezër Shqiptarë! Sot gjendem këtu në një ditë të vështirë dhe të gëzueshme për shpirtin tonë, duke qenë shqiptar me gjak, fis, me shpirt e me zemër, kam menduar me braktisë shtëpinë dhe familjen time dhe gjithë fuqinë që kam, me e dhënë jetën për çlirimin e Atdheut tim e të gjyshërve të mi dhe për me e ba bashkë Shqipërinë e shqiptarëve!”

Rëndësi ju dha listës së formësimit të anëtarëve të Qeverisë së Përkohshme të Kimzës, ku u përfshinë edhe Prend Uka (flamurtari i Berishës), dhe Frrok Kola, flamurtari i Thaçit, në të 24vetët e shënuar për Qeverinë e Përkohshme të Kimzës, themeluar më 27 prill 1911.(përfaqësuesit e formësimit të kësaj Qeverie!> Terenc Toçi; 2. Preng Tuc Doda, Fan; 3. Dedë Frroku, Kuzhnen, 4. Ndue Perdeda, Gojan; 5. Dod Bardhoku, Kthellë; 6. Kol Marka Kola, Orosh; 7. Gjeloš Kola, Shosh; 8. Pren Uka, Berishë; 9. Frrok Kola, Thaç; 10. Sadri Luka, Theth; 11. Gjoni Difi, Mertur; 12. Mark Sokolaj, Nikaj; 13. Qerim Ndou, Toplanë; 14. Prel Tuli, Mertur; 15. Ndue Marka Lleshi, Fan; 16. Ndue Ndrec Lazri, Dibër; 17. Ndue Gjoni Ndoci, Kuzhnen, 18. Ndue Frrok Deda, Spaç; 19. Zef Ndoi, Kimzë (Munellë, Spaç); 20. Ndue Gjoni Ndoci, Kuzhnen; 21. Geg Filip Çuni, Shkodër; 23. Preng Marka Gjeta, Kthellë; 24. Ndrec Gjega, Kthellë).

Duke parë rëndësinë historike të kësaj veprimtarie atdhetare të Dr. Terenc Toçit në këto treva të Maleve të Veriut me qëndër në Mirditë, kryetari komunës së Gjogjanit, Mark Mesuli, studiues i pasionuar i kësaj zone e më gjerë e përjetësoi në botimin e Tij të rëndësishëm “Një kullë në Histori, Qeveria e Kimzës 1911, ngjarje e Pavarësisë (Tiranë, Mirgeralb, 2007, 110 f.), ku përfshihen kumtesat dhe përshëndetjet për sesione shkencore kushtuar (95 e 100-vjetorit të Qeverisë së Kimzës, 2005 e 2011), që shënoi një sukses përkujtimor historik.

Për të mos mbetur me kaq njohje kjo ngjarje e rëndësishme historike, duke mos e lënë të zbehej në vëmendjen e brezave, sidomos te brezi i ri, Dod Nikoll Luli prej Lumziu, edhe pse me banim në Tiranë, nuk shkëputet dot prej vendlindjes, duke e vizituar stinë mbas stinë dhe duke nxitur shkrime e botime për te. Por kësaj here vendosi të kryej një akt ndërtimor memorial me interes historik ndërkrahinor, ku përfshihet përgjithësisht Shqipëria e Epërme, memorial-

in për Qeverinë e Përkohshme të Kimzës, 1911, ku gdhenet profili i Dr. Terenc Toçit dhe vargu i gjatë i 24 emrave të pjesëtarëve të kësaj “Qeverije të Përkohshme. Zbulimin e memorialit dhe fjalën e rastit e mbajti kryetari i Bashkisë Fran Tuci. Për të marrë pjesë dhe kumtuar në këtë ceremoni kishin ardhë edhe nga Akademia e shkencave, Tiranë: prof. dr. Maren-glen Verli, prof. dr. Beqir Meta, drejtor i Institutit të Historisë, prof. dr. Rexhep Uka, dr. Mark Pal Nika, studiuesi ingj. Kol Deda, si dhe studiuesit nga Puka, Xh. Meçi e Mark Mesuli. Përshtypje të veçantë lanë edhe të ftuari, i nipit i Dr. Terenc Toçit Dr. Terenzio, D’Alena Toçi nga Roma, Itali. Po kështu kishte ardhë nga USA (SHBA) për të përshëndetur një nipin e të përshëndritshmit pader Gjergj Fishta. Të cilët morën si dhuratë “KOMANI, Ana Drinit, Delmace, Pukë, trashëgimi Iliro-Arbërore. Më së fundmi për të gjithë të ftuarit në lokalitetin turistik të Ura Brah Neze shtroi një drekë përshëndetëse e falënderimi me plot bujar organizatori e drejtuesi i kësaj veprimtarie model i përkushtuarari Dod N. Luli.

Edhe pse kjo “Qeveri” nuk pati jetë të gjatë e vazhdimësi në misionin e saj, për shkak të ndërhyrjes së Austro-Hungarisë për rivalitet e zona influencë me Italinë fqinj, kjo ngjarje i afroi më shumë malet mes tyre për të arritur deri në fitoren e 28 Nëntorit 1912.

Me këtë, memorial, i nderuari Dod Nikoll Luli sjell edhe mesazhin, shembullin e Tij për të ndihmuar për raste të tilla, si sponsorizuesi Fran Gjok Daka të monumentit kushtuar MIGJENT bashkë me nxënësin e Tij ideal, ZENELIN. Po kështu vepra e Tij është mesazh edhe për bashkitë: Fushë-Arrës e Pukë, të cilat duhet t’i kushtojnë vëmendjen e duhur monumenteve për personalitete vendas si: Pashk Curri, Elez Selimi, Ymer Puka, i cili qe pjesëmarrës në 4 revolucione, duke luftuar në Spanjë me gradën major, derisa vritet më 1944, në luftë kundër pushtuesve nazist, në përkrahje të rezistencës franceze.

Ditët kalojnë, por kalimtarët vendas e turist sa herë kalojnë bri këtij memoriali gjigand, pyesin me admirim se si u arrit gjithë kjo përkujdesje e palodhur e Dod N. Lulit.

BIBLIOGRAFI, Plasari, Aurel- “Si (nuk) u shpall Pavarësia më 1911”. Gazeta “55”, Tiranë, 10 shkurt 2002, fq.41-50; Mesuli, Mark- “Një kullë në histori”; “Qeveria e Kimzës 1911, ngjarje e Pavarur”, Tiranë, 2007, (108 faqe); Leka, Pashk- “Personaliteti i lënë në hije, dom Nikollë Kimza”; Brahaj, Jaho- “Faqe mesjetare nga zona e Kallivares”; Xhemal Meçi- “Qeveria e Përkohshme në Kimzë të Mirditës”, fq. 63-68. Marku, Pal Nikollë- “95-vjetori i Qeverisë së Përkohshme të Kimzës”. Fq.58-62; Deda, Pashk- “Në tavandin e kullës, një “kuti me letra” e Qeverisë së Përkohshme”, fq. 49-51.

STUDIMI

74 VITE MË PARË U KËRKUA NGA KOSOVA QË TË BASHKOHET ME SHQIPËRINË, POR U ANEKSUA NGA SERBIA

Nga Bashkim Hisari

Gjatë dhe pas Luftës së Dytë Botërore qëndrimi jugosllav rreth statusit të Kosovës evoluoi. Deri në vitin 1943, ishin marrë shumë vendime, arritur marrëveshje për vetëvendosje sipas vullnetit të popullit të Kosovës, të bashkohej me Shqipërinë.

Ish udhëheqësi i Jugosllavisë, Josip Broz Tito fillimisht shumë qartë kishte përkrahur këtë ide. Ai në vitin 1946 në një intervistë për agjencinë amerikane "Associated Press" hapur ka thënë se Kosova dhe territoret të tjera shqiptare që ndodheshin në federatën jugosllave, do t'i kthehen Shqipërisë. "Nëse komunistët vijnë në pushtet në Shqipëri, ajo (Kosova) mund të jetë nën juridiksionin e Tiranës".

Edhe dora e djathtë e Titos, Eduard Kardel, me rastin e vizitës së tij në Moskë i kishte thënë Stalinit se Kosova do t'i jepet Shqipërisë.

Kreu i shtetit shqiptar, Enver Hoxha, theksonte se marsi i Titos i ka premtuar në fund të qershorit të vitit 1946, se Kosova dhe territoret të tjera me shumicë shqiptare do të jenë pjesë e Shqipërisë.

Megjithatë, Këshilli Antifashist i Çlirimtarëve të Jugosllavisë (AVNOJ), në seancën e dytë të tij më 29 nëntor 1943, vendosi ta krijojë Jugosllavinë federale ku sllavët e jugut do të jetonin në gjashtë republika. Në Rezolutën e miratuar Kosova nuk u përmend. Ideja e vetëvendosjes jo vetëm që nuk u respektua, por në mënyrën më të vrazhdë u shkel dhe u quajt si vendime armiqësore.

Përkundër faktit që mijëra kosovarë në brigadat partizane bashkë me ato të Shqipërisë luftuan italianët dhe gjermanët jo vetëm në territorin e Kosovës por edhe në territoret e Serbisë, Malit Zi e Bosnje-Herzegovinës dhe u çliruan nga nazi-fashizmi, Kosova në rrethana të turbullta politike, sociale, ekonomike dhe ushtarake në vitin 1945, u ripushtua dhe u aneksua. Ndërmjet shqiptarëve të Kosovës dhe Shqipërisë u ngrit muri i ndarjes dhe çështja e Kosovës e trevave tjera ngelën nën ish-Jugosllavi dhe të pazgjidhur.

Lidhur me statusin e Kosovës dhe për të diskutuar për çështjet e tjera aktuale një delegacion i Kosovës që kryesonte Mehmet Hoxha, kryetar KANÇ-it për Kosovën e Rrafshin e Dukagjinit, i zgjedhur në Konferencën historike në Bujan shkoi në Beograd për të biseduar me Titon. Antarët e delegacionit, përfaqësues të popullit të Kosovës dhe Rrafshit të Dugagjinit ishin: Qamil Luzha, Halim Spahiu, Mehmet Krileva, Ahmet Nishku, Ahmet Efendi Mitrovica, Demë Taraki, Hilmi Zariqi, Rifat Berisha, Ismail Haxhi Kaçaniku, Vesel Rexhepi, Ukë Sejdi Grabanica etj.

Ata detajisht kishin përkrahur terrorin që po ushtronte në gjithë Kosovën nga rregjimi ushtarak e policor që ishte vendosur nga Jugosllavia në fillim të vitit 1945. Treguan

Në vitin 1944, si komandant kryesor Fadil Hoxha kishte rreshtuar në brigadat antifashiste të Kosovës 53.127 luftëtarë, prej tyre 87% ishin shqiptarë. Ata bashkë me dy divizione të Ushtrisë Nacionalçlirimtare të Shqipërisë, faktorizuan shqiptarët dhe Kosovën që mos të coptohen tokat e tyre sikurse u nda Sanxhaku).



shëmbuj konkret të vrasjeve të shqiptarëve të pafajshëm në sy të familjeve. Andaj, kishin kërkuar të bëhen ndryshime të mënjëhershme, duke theksuar se populli i Kosovës ka luftuar për liri e drejtësi shoqërore edhe kundër robërisë së mbretërisë jugosllave, me qëllim që edhe shqiptarët të jenë të barabartë në të gjitha fushat me kombet e kombësitet e tjera në Jugosllavi dhe se duan paqe e mirëqytet midis kombësive në Jugosllavinë e re. Delegacioni i kishte përgaditur 7 kërkesa me shkrim Titos.

Kërkoni:

-Ligji agrar të përmirësohet.

-Administrata të drejtohet nga nëpunës shqiptarë dhe të flitet gjuha shqipe.

-Në Kosovë shqiptarëve t'u lejohen shkollat në gjuhën shqipe, të kenë mësues shqiptarë dhe këta t'ia kërkojnë Shqipërisë mësues derisa të përgatisin kuadrot në Kosovë në mënyrë që sa më shpejt të zhduket analfabetizmi që ishte 96% e popullatës.

-Shtetbërjet e tokave që janë bërë me kërcënime nga serbët të mos pranohen.

-Të burgosurit e pafajshëm të lirohen.

-Shqiptarët të kenë të drejtën e flamurit të kombit të vet.

-Shqiptarëve t'iu njihet e drejta për vetëvendosje.

Politikani dhe diplomati Jugosllav, arbreshi nga Zara, Josip Gjergja, që ishte pjesëmarrës në takim në shënimet e tij shkruan se Titoja ka dëgjuar me durim e kujdes kërkesat dhe, në sy të delegacionit, ato i ka vlerësuar si të drejta dhe ka thanë se do kërkojë përgjegjësi, që të bëheshin ndryshime rrënjësore për zhvillim e përparim të qytetarëve të Kosovës dhe kishte shtuar se po krijohej Jugosllavia e re e cila në krahasim se çfarë ka qenë Jugosllavia e vjetër, do jetë ndryshe për shqiptarët e Kosovës dhe Rrafshit të Dugagjinit. Ai ishte shprehur se në shtetin e ri, shqiptarët do të ndihen të barabartë me qytetarët dhe

çfarë kishin biseduar me Gjil-lasin dhe Rankoviqin lidhur me fatin e Kosovës. Fadil Hoxha ishte përgjegjës se në atë takim kishte folur vetëm Miladin Popoviqi, se takimi kishte qenë i shkurtër dhe se nuk është lejuar të takohen me Titon. Përfundimi i takimit kishte qenë se Miladini nuk është pajtuar që Kosova të ndahej si Sanxhaku. Në këtë takim me Fadil Hoxhën, këtë qëndrim Kardeli e kishte pranuar, por, kishte kërkuar prej tij që ta shfaq mendimin për Kosovën. Lidhur me këtë, Fadil Hoxha kishte konkluduar se nëse pyetet ai dhe populli shqiptar i Kosovës dhe Rrafshit të Dugagjinit, kjo trevë gjithmonë shqiptare dhe meqë ishte dëshmuar edhe me prova duke dhënë kontribut në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare krah për krah me popujt e Jugosllavisë dhe me popullin e Shqipërisë, kjo trevë gjithmonë shqiptare duhet t'i takonte Shqipërisë.

(Në vitin 1944, si komandant kryesor Fadil Hoxha kishte rreshtuar në brigadat antifashiste të Kosovës 53.127 luftëtarë, prej tyre 87% ishin shqiptarë. Ata bashkë me dy divizione të Ushtrisë Nacionalçlirimtare të Shqipërisë, faktorizuan shqiptarët dhe Kosovën që mos të coptohen tokat e tyre sikur që u nda Sanxhaku).

Por, në Kuvendin Antifashist të Çlirimtarëve Kombëtar të Serbisë, që është mbajtur me 7-9 prill të vitit 1945 në Beograd, ku nga Kosova kanë marrë pjesë si mysafirë Dushan Mugosha dhe Mehmet Hoxha, të cilët edhe kanë diskutuar në emër të Këshillit Nacionalçlirimtar të Kosovës e të Rrafshit të Dukagjinit, dhe në emër të popullit të Kosovës, Dushan Mugosha kishte shprehur dëshirën që Kosova t'i aneksohet Serbisë. "Ju përcjelli përshëndetjet dhe dëshirat e popullit të Kosovës e të Rrafshit të Dukagjinit... të shqiptarëve, serbëve e malaziasve, që t'i bashkohemi Serbisë federale vëllazërore" ishte shprehur Mugosha.

Edhe pse në fund të fjalimit të tij kishte vënë në dukje se "ne nuk e kemi marrë akoma këtë vendim në Kuvendin tonë, për shkak se në Kosovë ekziston pushteti ushtarak. "Dëshira" u shpreh pa u pyetur populli dhe për të u diskutua gjërisht në instancat më të larta partiake dhe shtetërore dhe ajo u shëndrrua në program politik e më vonë në ligj shtetëror. Kuvendi i Serbisë e konvertoi dëshirën në vendim dhe e pranoi aneksimin e Kosovës në Serbi duke e paraqitur atë si shprehje e vullnetit të vetë popullit të Kosovës.

Akti formal i aneksimit të Kosmetit, Serbisë në mënyrë arbitrare u bë në Kuvendin e Këshillit Popullor të Kosovës dhe Rrafshit të Dugagjinit, të mbajtur më 08 - 10 Korrik 1945 në Prizren.

Ishte ky një tubim i një trupi jo të zgjedhur nga pop-

ulli ku morën pjesë 137 delegatë dhe të ftuar të tjerë, nga të cilët vetëm 32 ishin shqiptarë të cilëturvejoheshin nga njerëz të armatosur të UDB-së. Në të nuk kishin marrë pjesë përfaqësuesit e Ushtrisë Nacionalçlirimtare të Shqipërisë dhe të aleatëve të tjerë të luftës, që do të ishin garantë, se, pas përfundimit të luftës, çështja e Kosovës do të zgjidhej në bazë të dëshirës dhe vullnetit të lirë të popullsisë shumicë.

Në Kuvend u miratua Rezoluta, që në një mënyrë mund të quhej dokumenti i parë zyrtar që legjitimoi aneksimin e Kosovës nga Serbia. Në mes tjerash thuhej: "Kuvendi Popullor Krahinor i Kosovës dhe i Rrafshit të Dukagjinit deklaroi, unanimisht, se popullsia e kësaj Krahine, si edhe të gjithë popujt e Jugosllavisë, nuk e kanë pranuar copëtimin e Krahinës së vet, që kanë bërë okupatorët, as copëtimin e Jugosllavisë, dhe shfaq dëshirën e tërë popullsisë së Krahinës, që kjo t'i bashkohet Serbisë Federale si pjesë përbërëse e saj..."

Sipas të dhënave rreth rezolutës dhe përmbytjes së saj nuk u hap ndonjë debat. Shumë pak delegatë diskutuan në mbledhje. Ata, që ishin dhe shprehën pakënaqësinë dhe kundërshtimin e bashkimit me Serbinë, më vonë, patën pasoja të mëdha. U përçollën nga organet e OZN-es, e më vonë të UDB-së, u arrestuan, u dënuan me burgim kurse disa u likuiduan fizikisht. Halim Spahia i cili kishte shprehur haptas mos pajtimin dhe kishte kundërshtuar vendosmërisht me fakte aneksimin e Kosovës nga Jugosllavia, hyrjen e Kosovës në Serbinë Federale dhe kishte kërkuar mbetjen e saj në përbërje të Shqipërisë etnike ishte dënuar me pushkatim si armik i Jugosllavisë së re. Ai u pushkatua më 16 shkurt 1946, bashkë me Tahir Dedën, Rexhep Kabashin, Rifat Krasniqi, Kajtas Ramadanin dhe Sefedin Ahmetin.

Me 3 shtator 1945, ligji i Kryesisë së Kuvendit Popullor të Serbisë "Mbi caktimin dhe ndërtimin e Rajonit Autonom të Kosovë-Metohisë" sanksiononte juridikisht Kosovën si njësi autonome. Kushtetuta e Republikës Federative Popullore të Jugosllavisë e janarit 1946 përcaktonte tërësinë e federatës me të gjitha subjektet përbërëse duke përmendur krahas Republikave edhe Krahinën Autonome të Kosovë-Metohisë në kuadër të Republikës Popullore të Serbisë.

Kështu pas aneksimit të Kosovës, për popullin shqiptar nisi një etapë e errët, një kalvar i vërtetë. Filluan përsëri masakrat masive mbi popullatën e pafajshme, likuidoheshin patriotët dhe intelektualët e pakët, në mënyrën më të vrazhdë. U shkelën të drejtat tyre dhe veprimet e tyre quheshin armiqësore.

NDERIMI

Promovohen dokumenatri dhe libri “Ruzhdi Baxhaku, një shok , një fisnik, një misionar”

Bashkia e Tiranës: “Mirënjohja e Qytetit” për ish-kolonelin Rruzhdi Baxhaku

Bashkia e Tiranës nderon me Titullin “Mirënjohja e Qytetit”, ish-kolonelin Rruzhdi Baxhaku në vitin e parë të ndarjes nga jeta, duke e vlerësuar për drejtimin me përkushtim, kompetencë e profesionalizëm të sektorit të Emergjencave Civile për gati dy dekada.

Dr.Erindi Bejko, Drejtor i Përgjithshëm i Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të Njësive Administrative dhe Emergjencave Civile në Bashkinë e Tiranës, duke i dorëzuar Familjes Baxhaku Titullin “Mirënjohja e Qytetit” për ish-kolonelin Rruzhdi Baxhaku, akorduar nga kryebashkiaku Erion Veliaj, foli për vlerat humane, profesionale dhe organizative të tij. Me Ruzhdiun, tha ai, përballuam shumë ngjarje, si tërmete, përmbajtje etj. Ne shihnim tek ai njeri, ekspertin me përvojë 15 vjeçare. Shpesh i drejtohem njëri tjetrit: “Ç’thotë komandanti për këtë problem?”. Dhe Ruzhdiu me qetësinë, profesionalizmin dhe përkushtimin na mësonte si ti zgjidhnim edhe ne detyrat më të vështira që nuk kishin ndodhur më parë.

E bija e Ruzhdiut, Anila, duke marrë certifikatën e mirënjohjes falenderoi Bashkinë e Tiranës dhe të gjithë



RUZHDI BAXHAKU

një shok, një fisnik, një misionar

Përgatiti: VASIL PREMÇI

ALB-TIPOGRAFIA

pjesëmarrësit për respektin dhe mirënjohjen që kanë treguar dhe treguan për babain e tyre. Për vlerat e Rr.Baxhakut

foli edhe ish-kolegu i tij, Baba Haxhi Dede Edmond Brahimaj,



kryetar i Kryegjyshitës Bektashiane Botërore me qendër në Tiranë.

“E kam patur shok, mik, vëlla. Së bashku kemi ndërtuar shumë objekte kulturi, teqe në të gjithë Shqipërinë. Zoti ju bekoftë të gjithë ju që keni ardhur sot për të nderuar kujtimin e shokut tonë Ruzhdi”,- theksoi Ai në fjalën e tij.

Zv.kryetari i OBVL (Orga-



nizatës së Veteranëve të Bashkuar të Veteranëve), kol. Myfit Guxholli përshëndeti në emër të kësaj organizate. Ai falenderoi organizatorët për këtë aktivitet përkujtimor për ushtarakun e karrierës, skënderbegasin dhe ish anëtarin e Këshillit Drejtues të OBVL, Ruzhdi Baxhaku. “Ne si OBVL vlerësojmë kontributin e tij si pasardhës veterani, për forcimin e konsolidimin e OBVL dhe mbrojtjen e vlerave të luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar”,-tha ndër të tjera kolonel Guxholli.

Kujtime impresionuese sollën nga takimet e bashkëpunimi me të ndjerin Rruzhdi Baxhaku miqtë e kolegët e tij, gjeneral (dr) Agim Lala, ish-drejtori i Emergjencave Civile në bashkinë e Tiranës, Erion Koka, shkrimtarët Shpendi Topollaji e Vasil Premçi.

Qindra pjesëmarrësit që mbushën sallën e Madhe të Muzeut Historik kombëtar në Tiranë, miq, bashkëpunëtorë, ish-ushtarakë, familjarë dhe të afërm ndoqën me interes dokumentarin “Ruzhdi Baxhaku, një shok , një fisnik, një misionar. Ndërkohë ata morën “dhuratë” librin me të njëjtin titull, me kujtime dhe opinione të 46 bashkëautorëve, përgatitur nga shkrimtari Vasil Premçi.

Sakip Cami

Fotot nga: Fehmi Lleshi

